

**Përafrimi i legjislacionit mjedisor të Kosovës me  
Konventën për Qasjen në Informata, Pjesëmarrje  
Publike në Vendimmarrje dhe Qasjes në Drejtësi në  
fushën e mjedisit  
(Konventa Aarhus)**



The Regional Environmental Center (REC)  
*for Central and Eastern Europe*  
Field Office Kosovo/a

## DIÇKA PËR REC – UN

Qendra Rajonale e Mjedisit për Evropën Qendrore dhe Lindore (REC), është një organizatë jo-advokuese dhe joprofit prurëse me mision që të ndihmojë zgjidhjen e problemeve mjedisore në Evropën Qendrore dhe Lindore.

Qendra e përmbush misionin e vet duke inkurajuar bashkëpunimin mes organizatave joqeveritare, qeverive, bizneseve dhe palëve tjera aktive në fushën e mjedisit, duke përkrahur shkëmbimin e lirë të informative dhe duke promovuar pjesëmarrjen publike në vendim marrjen mjedisore.

REC-u u themelua në vitin 1990 nga Shtetet e Bashkuara, Komisioni Evropian dhe shteti i Hungarisë. Sot REC ligjërisht bazohet në marrëveshjen e Kartës së nënshkruar nga 25 shtete dhe Komisioni Evropian, dhe në Marrëveshjen Ndërkombëtare me Qeverinë e Hungarisë.

REC-u në Kosovë punon që nga Qershori i vitit 2000, përmes zyrës së vet në Prishtinë. Programi i REC-ut në Kosovë përfshin përkrahjen institucionale për menaxhim mjedisor efikas, shoqëri të bazuar në dituri (edukim/informim të publikut të gjerë) dhe në komunitete të qëndrueshme.

REC Kosova ka zhvilluar programe parteriteti me të gjithë partnerët/donatorët që punojnë në Kosovë.

### **Kontakt:**

Zeqir Veselaj

Drejtor

The Regional Environmental Center (REC)

for Central and Eastern Europe

Zyra në Kosovë

Adresa: Kodra e Diellit, Rruga 3, Lamela 26, Prishtina, Kosovo/a

Mailing Address: FP 160, Prishtina, Kosovo/a

Tel/fax: (381 38) 552 123

E-mail: [info@kos.rec.org](mailto:info@kos.rec.org)

<http://kos.rec.org>

**Përafrimi i legjislacionit mjedisor të Kosovës me Konventën  
për Qasjen në Informata, Pjesëmarrje Publike në  
Vendimmarrje dhe Qasjes në Drejtësi në fushën e mjedisit  
(Konventa Aarhus)**

Përgatitur nga:

Visar Morina, Kandidat për Doktoratë  
Asistent në Universitetin e Prishtinës  
Fakulteti Juridik

Ky raport u përpilua si pjesë e projektit rajonal 'Përmirësimi i Pjesëmarrjes  
Publike: Hapat e Ardhshëm në Implementimin e Konventës Aarhus në Shqipëri,  
Bosnje dhe Hercegovinë, IRJ të Maqedonisë, Serbi dhe Mal të Zi, dhe në  
Kosovë'

**Financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, Holandë.**

Mars 2006, Prishtinë

**Përmbajtja:**

<b>SHKURTESAT:</b>	<b>5</b>
<b>1. <u>HYRJE</u></b>	<b>6</b>
<b>2. <u>KONVENTA MBI QASJEN NË INFORMATA, PJESËMARRJEN PUBLIKE NË VENDIM MARRJE DHE QASJEN NË DREJTËSI RRETH ÇËSHTJEVE MJEDISORE (KONVENTA “AARHUS”)</u></b>	<b>7</b>
2.1 QASJA NË INFORMATA MJEDISORE	9
2.2 PROCESI I PJESËMARRJES PUBLIKE NË VENDIM MARRJEN MJEDISORE	12
2.3 QASJA NË DREJTËSI	13
<b>3. <u>HARMONIZIMI I LEGJISLACIONIT MJEDISOR TË KOSOVËS ME PARIMET DHE KËRKESAT E KONVENTËS AARHUS</u></b>	<b>16</b>
3.1 KORNIZA KUSHTETUESE PËR INSTITUCIONET E PËRKOHËSHME VETËQEVERISËSE	16
3.2 LIGJI PËR QASJE NË DOKUMENTET ZYRTARE	18
3.3 LIGJI PËR MBROJTJEN E MJEDISIT NR. 2002/08	20
3.4 LIGJI PËR MBROJTJEN E AJRIT NR. 2004/30	23
3.5 LIGJI I UJËRAVE NR. 2004/24	25
3.6 LIGJI PËR ADMINISTRIMIN E MBETURINAVE	28
3.7 LIGJI PËR MBROJTJEN E NATYRËS	30
<b>4. <u>LEGJISLACIONI MJEDISOR KOMUNAL</u></b>	<b>33</b>
<b>5. <u>FAKTE DHE REKOMANDIME</u></b>	<b>36</b>

**Shkurtesat:**

IPVQ            Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes

KEDNJ            Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (1950)

KEKBE            Këshilli Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropë

KEPA            Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit

KK                Kuvendi i Kosovës

MMPH            Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

PSSP            Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm

REC              Qendra Rajonale për Mjedis

UNMIK            Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

VNM              Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis

*“Edhe pse për synim ka aspektin rajonal, rëndësia e Konventës së Aarhusit është globale. Ky është sigurisht elaborimi më mbresëlënës i parimit të 10 të Deklaratës së Rios, e cila thekson nevojën për pjesëmarrjen e qytetarëve në çështjet mjedisore dhe qasjen në informata mjedisore të mbajtura nga autoritetet publike. Si e tillë kjo konventë, paraqet hapin më ambicioz në fushën e demokracisë mjedisore, që është ndërmarrë ndonjëherë nën përkrahjen e Kombeve të Bashkuara”*

*Kofi A. Annan, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara<sup>1</sup>*

## **1. Hyrje**

Ky studim analizon procesin e përfshirjes së Konventës për Qasje në Informata, Pjesëmarrje Publike në Vendim Marrje dhe Qasje në Drejtësi në fushën e mjedisit, në legjislacionin mjedisor të Kosovës. Qëllimi është të theksohet përfshirja e Konventës së Aarhusit në legjislacionin që ka të bëjë me mbrojtjen e mjedisit. Duke ofruar një pasqyrë të përgjithshme të përfshirjes së Konventës Aarhus, ky studim synon të definojë masën e përfshirjes së parimeve dhe zgjidhjeve të ofruara nga Konventa Aarhus në ligjet mjedisore, përfshirë këtu edhe legjislacionin dytësor. Studimi, poashtu do të përpiqet të reflektojë shkallën e zbatimit të zgjidhjeve të Aarhusit edhe nga autoritetet publike në nivel lokal, posaçërisht sa i përket qasjes në informata mjedisore dhe pjesëmarrjes publike në proceset e vendim marrjes, përfshirë edhe zhvillimin e politikave mjedisore dhe hartimin e ligjeve. Me qëllim të arritjes së objektivës kryesore studimi është i ndarë në tri pjesë, të cilat duket sikur ofrojnë një platformë të mjaftueshme për të adresuar disa aspekte të Konventës Aarhus nga perspektiva e përfshirjes dhe implementimit të tyre nga autoritetet publike. Pjesa e parë përfshinë një pasqyrë të shkurtër të qëllimit, relevancës dhe përmbajtjes së Konventës Aarhus. Theks i veçantë i vihet tri shtyllave të konventës, gjegjësisht qasjes në informata, pjesëmarrjes publike në vendim marrje dhe qasjes në drejtësi. Pjesa e dytë ka të bëjë me përfshirjes e Konventës Aarhus në legjislacionin mjedisor primar dhe atë dytësor në Kosovë dhe mundohet të reflektojë shkallën e përfshirjes të parimeve të konventës në këtë legjislacion. Kjo pjesë, është në fakt thelbi i raportit dhe përqendrohen në zbulimin e procesit të përfshirjes së Konventës Aarhus në ligjet vendore si dhe mangësitë e legjislacionin, njëkohësisht duke ofruar edhe rekomandime për ndryshime të nevojshme me qëllim të dhënies së vendit të duhur të parimeve të konventës në legjislacionin mjedisor. Si është thënë edhe më parë, ky raport është një përmbledhje e gjithë analizës i cili bazohet në faktet dhe rekomandimet

<sup>1</sup> Cituar nga [<http://ëëë.unece.org/env/pp/>] 22.01.2006

kryesore që ndërlidhen me akomodimin e Konventës së Aarhusit në legjislacionin mjedisor kosovar. Ta shohim se çka është ndërmarrë në të vërtetë në këtë drejtim.

## **2. Konventa mbi Qasjen në Informata, Pjesëmarrjen Publike në Vendim Marrje dhe Qasjen në Drejtësi rreth Çështjeve Mjedisore (Konventa “Aarhus”)**

Konventa mbi Qasjen në Informata, Pjesëmarrjen Publike në Vendim Marrje dhe Qasjen në Drejtësi rreth Çështjeve Mjedisore (këtu e tutje i referohemi si Konventa e “Aarhusit”) është një kornizë normative ndërkombëtare e cila zë një vend të rëndësishëm në radhën e legjislacionin mjedisor ndërkombëtar.<sup>2</sup> Që nga aprovimi i saj në 1998, kjo është transformuar në një dokument ndërkombëtar me rëndësi kruciale, duke kërkuar kështu vëmendjen e legjislacioneve mjedisore të shumë vendeve të Evropës dhe jashtë saj.<sup>3</sup> Duke pasur parasysh rëndësinë e konventës dhe qëllimin e këtij raporti, është e nevojshme të përfshihen edhe disa informata teorike këtu. Konventa e Aarhusit u aprovua me 25 Qershor 1998 në qytetin Aarhus (Århus, Danimarkë) në Konferencën e katërt Ministrore në kuadër të procesit “Mjedisi për Evropën” dhe hyri në fuqi me 30 Tetor 2004.<sup>4</sup> Procesi i hartimit të Konventës u zhvillua nën përkrahjen e Këshillit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Evropë (UNECE)<sup>5</sup>, i cili në fushën e mjedisit synon të koordinojë aktivitetet e vendeve drejt arritjes së një zhvillimi të qëndrueshëm në Evropë.

Konventa Aarhus ka fituar një përkrahje të gjerë nga demokracitë mjedisore. Ashtu si përmendi, me të drejtë Sean McAllister, Konventa e Aarhusit konsiderohet si një “hap në bërjen e politikave mjedisore”, ngase ajo vendos një numër të primeve fundamentale në fushat e qasjes në informata publike dhe qasjes në drejtësi mjedisore.<sup>6</sup> Shumë

<sup>2</sup> Qasja në informata mjedisore në nivel të bashkësisë Evropiane rregullohet me Direktivën e BE mbi Qasjen e Publikut në Informata Mjedisore të BE 2003, dhe revokimin e Direktivës së Këshillit 90/313 EEC.

<sup>3</sup> Konventa e Aarhusit u plotësua me Protokolin e Regjistrave të Lirimit të Ndotjes dhe Transferit, i cili u aprovua në një takim të jashtëzakonshëm të palëve me 21 Maj 2003, në Kiev. Në takimin e dytë të palëve të mbajtur në Almaty, Kazakistan, me 25-27 Maj 2005, u aprovua një amandament i Konventës “duke vendosur dispozita më të sakta për pjesëmarrjen publike në vendim marrje sa i përket lirimit të qëllimshëm të organizmave të modifikuar gjenetikisht, duke përmblur kështu një debat të gjatë rreth kësaj teme”. Për më shumë shih <http://www.unece.org/env/pp/> vendosur me (22.01.2006)

<sup>4</sup> Teksti i Konventës së Aarhusit mund të gjindet në <http://europa.eu.int/comm/environment/aarhus/>.

<sup>5</sup> Për më shumë informata rreth aktiviteteve të UNECE, shih ëbfaqen zyrtare të Këshillit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Evropë <http://www.unece.org/about/about.htm>.

<sup>6</sup> Sean T. McAllister, ‘Të Drejtat e Njeriut dhe Mjedisi: Konventa mbi Qasjen në Informata, Pjesëmarrja Publike në vendim marrje dhe Qasje në Drejtësi lidhur me Çështjet Mjedisore’. *Colorado Journal of International Environmental Law and Policy*, 1998 fq. 187; Për një pasqyrë rreth zbatimit të legjislacionit mjedisor në Evropën lindore, shih dokumentin ‘Citizen Enforcement Of Environmental Law In Eastern

vende evropiane e kanë formësuar legjislacionin e tyre mjedisor në pajtim me parimet e Konvntës Aarhus. Procesi i inkorporimit të Konvntës Aarhus në legjislacionin vendor mjedisor, flet për zbatimin gjithnjë e më të madh të Konventës Aarhus në jurispodencat nacionale.

Vlen të përmendet që edhe korniza e Konventës së Aarhusit e përshkruar në pjesën hyrëse të saj është inspiruar dhe bazuar në një numër instrumentesh ligjore dhe deklaratave ndërkombëtare në kuadër të synimeve për mbrojtjen dhe promovimin e mjedisit. Në pajtim me këtë edhe parimi 1 i Deklaratës së Stokholmit për të Drejtat e Njeriut edhe parimi 10 i Deklaratës së Rios për Zhvillimin e Mjedisit kanë gjetur vendin e tyre që në hyrje të Konventës.<sup>7</sup> E njëjta vlen edhe për rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme 37/7 të datës 28 Tetor 1982 në Kartën Botërore për Natyrën dhe 45/94 të datës 14 Dhjetor 1990 mbi domosdoshmërinë për të siguruar një mjedis të shëndoshë për mirëqenien e individëve, si dhe në Kartën Evropiane për Mjedisin dhe Shëndetin, të aprovuar në vitin 1989, e cila përkrah dokumenteve tjera i jep vëmendje të posaçme Konventës Aarhus.<sup>8</sup>

Duhet të përmendet fakti që Konventa Aarhus nuk e ndikon ‘të drejtën e palës për të ndërmarrë apo vendos masa për të ofruar një qasje në informata, pjesëmarrje të publikut në vendim marrje dhe qasje në drejtësinë mjedisore më të gjerë dhe më të përhapur se sa që specifikohet në këtë Konvntë’<sup>9</sup> Neni 3, paragrafi 7 i Konvntës për më tej siguron që ‘secila palë do të promovojë aplikimin e parimeve të Konventës në proceset ndërkombëtare të vendim marrjes mjedisore dhe brenda kornizës së organizatave ndërkombëtare, në çështjet që ndërlidhen më mjedisin.’

---

Europe’ nga Dr. Svitlana Kravchenko (Carlton Savage Profesor i Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Paqes, Shkolla Juridike, Universiteti i Oregonit, Doktor i Juridikut), Ëidener Laë Revieë, 2004. Artikulli gjendet në LexisNexis. Shih poashtu STEPHEN STEC, ‘Të drejtat ekologjike përparojnë sundimin e ligjit në Evropën lindore’, *Journal of Environmental Law and Litigation* (1998).

<sup>7</sup> Parimi 10 i Deklaratës së Rios për Zhvillimin e Mjedisit siguron që “çështjet mjedisore trajtohen më së miri me pjesëmarrjen e qytetarëve përkatës, në nivelin relevant. Në nivel nacional, çdo individ do të qetë qasjen adekuate në informata që kanë të bëjnë me mjedisin dhe që mbahen nga autoritetet publike, përfshirë këtu edhe informata mbi matërit e rrezikshme dhe aktivitetet në komunitetet e tyre, dhe duhet tu ipet mundësi për pjesëmarrje në procesin e vendim marrjes. Shtetet duhet të mundësojnë dhe inkurajojnë ndërgjegjësimin publik dhe pjesëmarrjen publike duke lejuar qasje në informata. Do të lejohet qasje efikase në seancat administrative dhe ligjore, përfshirë edhe riparimin dhe rehabilitimin”.

<sup>8</sup> Marrëveshja Evropiane për Mjedis dhe Shëndet (Konferenca e Parë Evropiane për Mjedisin dhe Shëndetin, Frankfurt, 7-8 Dhjetor 1989).

<sup>9</sup> Neni 3.5



Konvnteta Aarhus është e strukturuar në tri shtylla kryesore. Shtylla e parë rregullon çështjen për qasje në informata mjedisore. Shtylla e dytë trajton çështjen e pjesëmarrjes publike në vendimmarrje në fushën e mjedisit. Shtylla e fundit ka të bëjë me qasjen në drejtësi mjedisore. Kjo strukturë e Konvnetës Aarhus, prej tri shtyllash do të përdoret për të shpjeguar shkurtimisht kërkesat që dalin nga kjo Konvnetë dhe obligimet të cilave shtetet duhet t'u përmbahen në kornizën e tyre rregullative.

Duhet shtuar edhe që BE u bë Plaë e Konventës Aarhus në Maj 2005. Vendimi për të përmbyll Konvnetën Aarhus nga KE u mor me 17 Shkurt 2005 (Vendimi 2005/370/EC). Në 2003 u aprovuan dy direktiva që kishin të bëjnë me “shtyllen” e parë dhe të dytë.<sup>10</sup> Direktiva 2003/4/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 28 Janar 2003 për qasje në informata mjedisore, shfuqizon Direktivën e Këshillit 90/31/EEC dhe Direktivën 2003/35/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 26 Maj 2003, siguron pjesëmarrje publike sa i përket përgatitjes së planeve dhe programeve që ndërlidhen me mjedisin dhe për ndryshimin e Direktivës së Këshillit 85/337/EEC dhe 96/61/EC për pjesëmarrje publike

## 2.1 Qasja në informata mjedisore

Si u tha më parë komponentë e parë të cilën e shtjellon Konventa është qasja në informata mjedisore.<sup>11</sup> Qasja e qytetarëve në informata dhe të dhëna mjedisore që janë në interes publik, të mbajtura nga autoritetet publike është e rëndësishme për secilën demokraci mjedisore. Ajo vendo një urë komunikimi mes qytetarëve dhe autoriteteve publike në proceset e vendim marrjes mjedisore dhe u mundëson qytetarëve të marrin pjesë në procesin e zhvillimit të politikave mjedisore (OJQ dhe sektorit privat) dhe të kenë një rol aktiv në këtë proces.

<sup>10</sup> Shih <http://ec.europa.eu/comm/environment/aarhus/>

<sup>11</sup> Neni 2 para. 3 i Konventës së Aarhusit, “Informatë Mjedisore” nënkupton: çdo informacion me shkrim, vizual, gojor, elektronik ose çdo lloj forme tjetër materiali mbi: (a) Gjendjen e elementeve të mjedisit, të tilla si, ajri e atmosfera, uji, toka, pejsazhi e shumëllojshmëria biologjike dhe komponentët e tij, duke përfshirë organizmat e modifikuar gjenetike dhe ndërveprimin midis këtyre elementeve. (b) Faktorë, të tillë si substancat, energjia, zhurmat e rrezatimi, dhe aktivitetet ose masat, përfshirë masat administrative, marrëveshjet mjedisore, politikat, legjisllacionin, planet dhe programet, të cilat ndikojnë ose mund të ndikojnë elementet e mjedisit, brenda fushës së nënparagrafit (a) më lart, kostot-përfitimet dhe analizat e tjera ekonomike, si edhe supozimet e përdorura në vendim marrjen mjedisore; (c) Gjendjen e shëndetit të njeriut dhe sigurisë së tij, kushtet e jetës njerëzore, vendet kulturore dhe strukturat e ndërtuara nga njeriu, në shkallën në të cilën ato ndikohen ose mund të ndikohen nga gjendja e elementëve të mjedisit, ose përmes këtyre elementëve, nga faktorët, aktivitetet, ose masat të referuara në nënparagrafin (b), më sipër.

Parimi i qasjes në informata mjedisore ngrit poashtu edhe vetëdijen e përgjithshme qytetare kundrejt nevojës së autoriteteve publike për të siguruar transparencë të plotë dhe shpërndarje të informatave relevante për komunitetin mjedisor.<sup>12</sup> Për më shumë Neni 4 i Konventës i referohet në mënyrë eksplicite të drejtës për qasje në informata mjedisore. Ai thjesht siguron që Palët Kontraktuese duhet të sigurojnë që autoritetet publike lëshojnë informatat e kërkuara në kërkesën për informata mjedisore brenda legjislacionit nacional. Sipas Pjesës 4, para. 2 “Informacioni mjedisor, referuar në paragrafin 1 më lart, do të bëhet i disponueshëm sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se një muaj pas paraqitjes së kërkesës, vetëm në rastet kur volumi dhe kompleksiteti i informacionit e justifikon zgjatjen e kësaj periudhe deri në dy muaj pas kërkesës<sup>13</sup>. Në rast të shtyrjes së afatit autoriteti publik duhet të njoftojë kërkuuesin e informacionit për çdo shtyrje të afatit kohor dhe për arsyet që justifikojnë këtë shtyrje”.<sup>14</sup> Me qëllim të parandalimit të diskrecioneve arbitrare të autoriteteve lokale, Pjesa 4 përcakton rregullat dhe procedurat e përgjithshme të cilat nuk guxojnë të shkelen nga autoritetet publike kur kanë të bëjnë me kërkesa për qasje në informata publike.<sup>15</sup>

Përveç të drejtës subjektive për qasje në informata, Konventa Aarhus shtjellon edhe shpërndarjen e informatave mjedisore nga autoritetet si një komponent mjaft të rëndësishme të qasjes në informata mjedisore. Konventa kërkon nga autoritet publike t'i ofrojnë dhe shpërndajnë informata mjedisore publikut sa më shumë që është e mundur. Varësisht prej rëndësisë së informatave për publikun e përgjithshëm, Konventa përcakton nevojën për të ofruar informatat në mënyrë transparente, kërkon vendosjen

<sup>12</sup> Pjesa 5 para. 2 thotë: “Çdo Palë do të sigurojë që, brenda kuadrit të legjislacionit dhe praktikave kombëtare, mënyra në të cilën autoritetet publike e bëjnë informacionin mjedisor të disponueshëm për publikun, të jetë transparente dhe e drejta për ta patur atë të ushtrohet efektivisht, midis të tjerave, (a) Duke i dhënë informacion të mjaftueshëm publikut, për llojin dhe sferën e informacionit mjedisor, të zotëruar nga autoritetet përkatëse publike, kushtet bazë në të cilat një informacion i tillë bëhet i disponueshëm, dhe për procesin me anë të të cilit, ky informacion mund të sigurohet; (b) Duke krijuar apo ruajtur praktika të tilla si: (i) Disponimi i listave, regjistrave ose dosje informative për publikun; (ii) Kërkesa që zyrtarët të mbështesin publikun, në kërkim të së drejtës për informacion sipas kësaj konvente; dhe (iii) Identifikimi i pikave të kontaktit; (c) Duke dhënë pa pagesë informacionin që përmbajnë listat, regjistrat ose dosjet sipas nënparagrafit (b-i) më lart.”

<sup>13</sup> Pjesa 4 para. 2 i Konventës së Aarhusit

<sup>14</sup> Ibid

<sup>15</sup> Pjesa 4 pika 3 e Konventës së Aarhusit Një kërkesë për informacion mjedisor mund të refuzohet në qoftë se: (a) Autoriteti publik, të cilit i adresohet kërkesa, nuk e ka informacionin mjedisor të kërkuar; (b) Kërkesa është paraqitur në mënyrë tepër të paarsyeshme ose është formuluar në një mënyrë shumë të përgjithshme; (c) Kërkesa ka të bëjë me një material që është në përfundim ose ka të bëjë me komunikimin e brendshëm të autoriteteve publike, në rast se një përjashtim i tillë parashikohet në ligjin ose në praktikat e përditshme kombëtare, duke marrë parasysh që dhënia e informacionit i shërben interesit publik.

dhe mirëmbajtjen e aranzhimeve praktike për të mundësuar ofrimin e informatave qoftë si lista publike, baza të dhënave elektronike, duke ofruar kështu përkrahje aktive nga zyrtarët për ata që kërkojnë informata. Duhet synuar që sa më shumë që është e mundur informatat mjedisore të ofrohen në mënyrë elektronike (Neni 5.3). Informata e këtij formati, nëse janë në dispozicion duhet të përfshijnë raporte mbi gjendjen e mjedisit, tekste të legjislacionit, aty ku është e mundur, tekste të politikave mjedisore, planeve dhe programeve, përfshirë edhe përmbajtjet e marrëveshjeve, konventave, legjislacionin mjedisor nacional, rajonal dhe lokal si dhe legjislacionin relevant për mjedisin.<sup>16</sup> Secila nga Palët Kontraktuese kanë përgjegjësi që në intervale të rregullta kohore jo më të gjata se tri apo katër vite, të publikojnë dhe shpërndajnë një raport nacional për gjendjen mjedisore (Neni 5.4).

Për më tej shpërndarja e informatave mjedisore, inter alia, duhet që së paku të përfshijë edhe dokumente të legjislacionit dhe politikave (si strategjitë, politikat, programet, dhe planet e veprimit, që ndërlidhen me mjedisin, dhe raportet e progresit rreth implementimit të tyre të përgatitura nga qeveria në faza të ndryshme të zbatimit), traktatet ndërkombëtare, konventat dhe marrëveshjet për çështje mjedisore dhe dokumentet të rëndësishme ndërkombëtare që ndërlidhen me mjedisin (Neni 5.5).

Konvntenta poashut vendos disa dispozita për prodhimin e informatave. Neni 5 paragrafi 8, siguron që Palët duhet të dizajnojnë dhe zhvillojnë mekanizma institucional “me qëllim të sigurimit që prodhimi i mjaftueshëm i informatave i ofrohet publikut në një mënyrë që mundëson konsumuesin të marr vendime mjedisore të informuara mirë.” Për më shumë, Palët e Konvntës pritet të ndërmarrin hapa në vendosjen progresive “të sistemit nacional dhe koherent të inventarëve dhe regjistrave të ndotësve në një bazë të dhënash elektronike, të kompjuterizuar ku kanë qasje publiku, e cila përcillet me raportim të strukturuar”.<sup>17</sup> Një sistem i tillë mund të përfshijë të hyra, nxjerrjen dhe transferin e një numër substancash dhe produktesh të një rangu specifik, përfshirë këtu ujërat, energjinë dhe shfrytëzimin e një rangu specifik të aktiviteteve mjedisore, duke filluar nga mediat e deri te trajtimi i vend hedhurinave në terren dhe jashtë terrenit.

---

<sup>16</sup> Shih Nenin 5 të Konventës së Aarhusit lidhur me mbledhjen dhe shpërndarjen e informative mjedisore.

<sup>17</sup> Neni 5.9

## 2.2 Procesi i pjesëmarrjes publike në vendim marrjen mjedisore

Duke parë rëndësinë e rolit të qytetarëve individual, organizatave jo-qeveritare dhe sektorit privat në mbrojtjen e mjedisit, Konventa Aarhus ofron një platformë të mjaftueshme normative për të mundësuar një pjesëmarrje civile aktive në zhvillimin e projekteve, programeve, planeve, politikave dhe legjislacionit mjedisor. Pjesëmarrja publike në vendim marrje në çështjet e lidhura me mjedisin është definuar në Nenin 6, 7 dhe 8 të Konventës.

Neni 6.2 siguron që “publiku në fjalë do të informohet, qoftë përmes lajmërimeve publike apo individuale sa më herët që është e mundur në procesin e vendimmarrjes mjedisore; dhe në një mënyrë adekuate; në kohë të duhur dhe me efikasitet”, inter alia, për aktivitetet e propozuara, natyrën e vendimeve të muindëshme apo draft vendimeve, nga autoriteti publik përgjegjës për të marr vendim dhe për procedurat përkatëse<sup>18</sup> dhe për faktin që ky “aktivitet i nënshtrohet procedurave ndër kufitare për vlerësim të ndikimit në mjedis”. Për të mundësuar aktivitetet të hershme të involvimit në mbrojtjen dhe promovimin e çështjeve mjedisore, Konventa kërkon që Palët Kontraktuese të ofrojnë me kohë informatat rreth procedurës së vendim marrjes mjedisore, sidomos ato informata në bazë të cilave do të merren vendimet.<sup>19</sup> Konventa Aarhus poashtu kërkon që procedurat duhet të përfshijnë afate të arsyeshme kohore, duke lejuar kështu kohë të mjaftueshme për të informuar publikun dhe t’i lejuar publikut kohë për tu përgatitur dhe për të marrë pjesë në mënyrë efektive gjatë vendim marrjes mjedisore dhe ofron kërkesat minimale për njoftimin e publikut. Duke pasur parasysh që pjesëmarrja publike në vendim marrje përmirëson kualitetin dhe implementimin e vendimeve mjedisore, Konventa kërkon që procedurat e pjesëmarrjes publike të mundësojnë publikun të dorëzoj komentet, informatat, analizat apo mendimet (në formë të shkruar apo gojore gjatë takimeve publike, apo si kërkesë nga aplikuesi), që mund të jenë relevante për aktivitetet e propozuara dhe që vendimet të marrim parasysh sa më shumë që është e mundur preferencat që dalin nga pjesëmarrja publike.

Sipas Nenit 7 të Konventës së Aarhusit konsultimet dhe pjesëmarrja publike duhet të mbahen në një kornizë transparente dhe të drejtë gjithmonë kur autoritetet publike janë

<sup>18</sup> Duke përfshirë kohën kur dhe si mund të ofrohen këto të dhëna  
(i)

<sup>19</sup> Neni 6 i Konventës së Aarhusit

duke zhvilluar plane apo programe që ndërlidhen me mjedisin. E njëjta vlen edhe për adoptimin e rregullative dhe akteve normative për mbrojtjen e mjedisit. Sipas Nenit 8 të Konventës, autoritetet publike duhet të synojnë mbajtjen e konsultimeve të gjëra dhe efikase publike gjatë gjithë etapave të hartimit të ligjeve, rregulloreve dhe normave tjera ligjore që mund të kenë ndikim të mirëfilltë në gjendjen e mjedisit.<sup>20</sup> Për këtë qëllim, autoritetet nacionale duhet të lejojnë afate të mjaftueshme kohore për pjesëmarrje efektive, të publikohen rregullat apo të njoftohet publiku në mënyra tjera duke i lejuar publikut kështu mundësi për të komentuar rregullat qoftë në mënyrë personale apo përmes një trupi përfaqësues konsultativ. Së fundi Neni 8 i Konventës Aarhus siguron që rezultati i pjesëmarrjes publike duhet të mirret parasysh sa më shumë që është e mundur nga autoritetet relevante.

### 2.3 Qasja në drejtësi

Komponentë e tretë e Konventës së Aarhusit ka të bëjë me qasjen në drejtësi për çështjet mjedisore. Është e qartë se qasja në drejtësi për çështjet mjedisore është me rëndësi kyçe për sigurimin e implementimit dhe fuqizimit të legjislacionit dhe politikave dhe të drejtave që lidhen me qasjen në informata mjedisore dhe pjesëmarrjen publike në vendim marrje në fushën mjedisore.<sup>21</sup> Qasja në informata mjedisore dhe pjesëmarrja publike në vendim marrje në projektet specifike, projektet, programet dhe planet, politikat dhe legjislacionin që ndërlidhet me mjedisin do të ishte e pakuptimtë nëse qytetari nuk do të kishte në dispozicion instrumentet ligjore për të adresuar thyerjen e të drejtave të tij mjedisore. Qasja në drejtësi mjedisore është thelbi i asaj që quajmë ‘demokraci mjedisore’, e cila duhet të ofrohen nga autoritetet publike në mënyrë të drejtë, të pavarur dhe efikase.

Sipas Nenit 9 të Konventës, Palët Kontraktuese, brenda kornizës së legjislacionit nacional, duhet të sigurojnë që secili person i cili deklaron që “kërkesa e tij për informacion sipas nenit 4 është nënvlerësuar, refuzuar gabimisht, ... ose nuk është trajtuar në përputhje me dispozitat” e ligjit, ka të drejtë për të pasur një procedurë shqyrtimi përpara gjykatës ose çdo organi tjetër të pavarur dhe të paanshëm. Në bazë të kësaj rregulle, çdo person i cili deklaron që kërkesa e tij për informacion është

<sup>20</sup> Neni 7 i Konventës së Aarhusit

<sup>21</sup> Për një pasqyrë të Qasjes në Drejtësi sipas Konventës së Aarhusit, shih ‘[Handbook on Access to Justice under the Aarhus Convention](#)’ përgatitur nga Qendra Rajonale për Mjedis për Evropën Qendrore dhe Lindore, (REC), Hungari 2003.

ignoruar, refuzuar gabimisht, ose nuk është trajtuar nga autoritetet publike në përputhje me Konventën, ka të drejtë të kërkoj shqyrtimin e këtij vendimi në gjykatë e ligjshme në një procedurë të drejtë dhe të paanshme ligjore. Neni 9.1 siguron që Plaët Kontraktuese të Konventës sigurojnë që “një person i tillë ka poashtu qasje në procedurën e kushtueshme të vendosur me ligj e cila do të jetë pa pagesë për rishqyrtim nga autoriteti publik apo nga një organ i pavarur dhe i paanshëm apo ndonjë gjykatë tjetër ligjore”. Vendimi përfundimtar i gjyqit, thotë Konventa “do të jetë i detyrueshëm për autoritetin publik që mban informatën e kërkuar”.<sup>22</sup>

Përveç rishqyrtimit juridik të çështjeve që nënkupton qasjen në informata mjedisore Neni 9.2 i Konventës Aarhus kërkon nga Palët Kontraktuese që të ofrojnë rishqyrtim juridik të akteve që prekin të drejtat që dalin nga Neni 6 i Konventës Aarhus. Neni 9.2 siguron që “Çdo Palë, brenda kuadrit të legjisllacionit kombëtar, do të sigurojë që anëtarët e publikut të interesuar (kanë interes të mjaftueshëm, ose u është cënuar një e drejtë, në rast se ligji procedural i një Pale e kërkon këtë si parakusht),do të kenë të drejtën për një procedurë shqyrtimi përpara gjykatës dhe/ose çdo organi tjetër të pavarur dhe të paanshëm, të krijuar me ligj, për të mos pranuar legalitetin substantiv dhe procedural të çdo vendimi, akti ose lënie mënjanë, sipas klauzolave të nenit 6 dhe, kur kjo parashikohet në ligjin kombëtar dhe pa paragjykuar paragrafin 3 më poshtë, të klauzolave të tjera përkatëse të kësaj Konvente”.

Ka tri kategori të gabimeve procedurale të cilat ka mundësi të dalin nga kërkesat e Nenit 6 të Konventës Aarhus, të cilat i nënshtrohen vlerësimit juridik.<sup>23</sup>

- Dështimi për t’i ofruar publikut të gjitha informatat relevante për pjesëmarrjen e tij;
- Procedura jo adekuate për pjesëmarrje të publikut, si për shembull lajmërimi me kohë dhe adekuat, mundësia për të komentuar, afatet kohore, kufizimet e ‘qëndrimeve administrative’; dhe
- Reagim jo adekuat ndaj komenteve të pranuar (dështim për ti marr parasysh ato) apo dështim për të sqaruar arsyet dhe konsiderimet e marra parasysh gjatë marrjes së vendimit.

Çdo individ nga Palët Kontraktuese, i cili sopozon që të drejtat e sa apo të tij, si janë përcaktuar me Nenin 6 të Konventës Aarhus, ka të drejtë të inicojë procedurë juridike për të rishqyrtuar këtë vendim në gjykatën kompetente.

<sup>22</sup> Neni 7 para. 1 i Konventës së Aarhusit

<sup>23</sup> Doracaku REC fq 29

Neni 9.3 i Konventës Aarhus më tej ofron mbrojtje të drejtave individuale mjedisore në lidhje me aktivitetet apo pengesat e autoriteteve publike apo individëve privat, në kundërshtim me legjislacionin mjedisor. Pa paragjykime sa i përket procedurës së rishqyrtimit të cilës i referohemi në paragrafet 1 dhe 2 të nenit 9, secila Plaë duhet të sigurojë që “në rastet kur anëtarët e publikut plotësojnë kriteret, në se ka të tilla në ligjin kombëtar, ata do të kenë të drejtë për t’iu drejtuar procedurave administrative ose gjyqësore për të mos pranuar veprimet apo neglizhimet nga personat privatë dhe autoritetet publike, të cilat janë në kundërshtim me klauzolat e legjislacionit të vet kombëtar, në lidhje me mjedisin” Formulimi është mjaft i gjerë dhe përfshin një numër të madh ligjesh mjedisore. Ka dy çështje kryesore që dalin nga neni 9.3. mundësia që individët, OJQ, trupat qeveritar, të “zbatojnë ligjin përkundër personave jashtë qeverisë” (p.sh ndërmarrjesve) dhe e drejta e qytetarëve për t’u ankuar rreth veprimeve ose pengesave të autoriteteve qeveritare që nuk i përbahen legjislacionit mjedisor.<sup>24</sup> Konventa më tutje kërkon nga Palët që të vendosin korniza të tilla në legjislacionin e tyre mjedisor, të cilat duhet të respektohen nga autoritetet nacionale gjatë vendosjes së procedurave për rishqyrtim juridik dhe administrativ të vendimeve mjedisore, si dhe për të zbatuar obligimet e Nenit 9.4, sa i përket sigurimit të masave adekuate dhe efektive për kompensim, procedura të barabarta, në kohë të duhur, dhe jo të shtrenjta si dhe për themelimin e mekanizmave të përshtatshëm për të mënjanuar apo reduktuar pengesat për qasje në drejtësi (Neni 9.5).

---

<sup>24</sup> Doracaku REC fq 31

### **3. Harmonizimi i legjislacionit mjedisor të Kosovës me parimet dhe kërkesat e Konventës Aarhus**

#### **3.1 Korniza Kushtetuese për Institucionet e Përkohëshme Vetëqeverisëse**

Është me rëndësi që këtu të dhëmë disa komente relevante rreth Kornizës Kushtetuese të Institucioneve të Përkohëshme Vetëqeverisëse (tash e tutje Korniza Kushtetuese). Korniza Kushtetuese u aprovua në Maj 2001 për të rregulluar organizimim dhe funksionimin e organeve legjislative, ekzekutive dhe juridike të Kosovës.<sup>25</sup> Nga fusha e të drejtave të njeriut Korniza Kushtetuese vendos bazën për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut relevante për ndërtimin e demokracisë dhe sundimin e ligjit. Është qenësore të theksohet se teksti i Kornizës Kushtetuese nuk përmban një kapitull të veçant mbi të drejtat konstitutive dhe liritë fundamentale. Ajo thjesht u referohet traktateve kryesore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, duke theksuar se “institucionet e përkohshme vetqeverisëse do të respektojnë dhe sigurojnë standardet e pranuar në fushën e të drejtave të njeriut dhe lirive fundamentale, përfshirë këtu edhe të drejtat dhe liritë” të përfshira në instrumentet ndërkombëtare bazike për të drejtat e njeriut.<sup>26</sup> Si mund të shihet institucionet e përkohëshme të Kosovës obligohen të respektojnë instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, përfshirë këtu edhe dispozitat që lidhen me të drejtën për qasje në informata mjedisore. Thurja tekstuale e Kornizës Kushtetuese është mjaft e përgjithshme dhe mënyra si dhe instrumentet ligjore për zbatimin e instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut lihen plotësisht në duart e organeve publike që kanë të bëjnë me qasjen në informata mjedisore. Të tilla janë p.sh Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, e cila sipas kësaj kornize mund të aplikojë ciëndo konventë lidhur me qasjen në informata mjedisore. Nën aranzhimet aktuale kushtetuese nuk kërkohen procedura ratifikimi për të kryer një aplikim të tillë. Mirëpo nga pikëpamja ligjore kjo punë nuk është edhe aq e lehtë sa duket. Nuk duhet harruar se Korniza Kushtetuese le një numër mangësish në kontekst të futjes së traktateve ndërkombëtare në ligjet vendore. Për vrojtuesit ligjor, këto mangësi mbeten

<sup>25</sup> Korniza Kushtetuese për Institucionet e Përkohëshme të Vetëqeverisjes në Kosovë mund të gjendet në formatin Ëord në ëbfaqen: <http://www.unmikonline.org/constframeëork.htm> [20.01.2006]

<sup>26</sup> Deklarata Universale për të Drejtat e njeriut; (b) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e Të Drejtave dhe Lirive Fundamentale të Njeriut dhe Protokollet e saj; (c) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Protokollet përkatës; (d) Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimeve Raciste; (e) Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimeve kundër Grave; (f) Konventa për të Drejtat e Fëmijës; (g) Marrëveshja Evropiane për Gjuhët Rajonale apo Minoritare; dhe (h) Konventa Kornizë e Këshillit Evropian për Mbrojtjen e Minoriteteve Nacionale.



shumë evidente. Çështja më brengosëse është se sfera e instrumenteve ndërkombëtar për të drejtat e njeriut mbetet poaq e ndryshueshme sa edhe vet gjuha e përdorur. Përpilimi tekstual i traktave për të drejtat dhe liritë e njeriut del si i ndryshëm duke paraqitur qëllime të ndryshme, çka pengon autoritetet kompetente në sigurimin e një vazhdimësie të aplikimit të instrumenteve të tilla në ligjet vendore. Të ilustruara këtu më një shembull: përderisa Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike ka përdorur tekst më të kufizuar, duke siguruar vetëm të drejtën për të pranuar dhe shpërndarë informata, por nuk përmend të drejtën për të kërkuar informata. Duhet kushtuar vëmendje e posaçme zbatimit të traktateve të tilla, në çështjet që kanë të bëjnë me qasjen në informata mjedisore – që është e përfshirë në Aarhus – qasjen në drejtësi mjedisore. Pyetja që del nga këndvështrimi ligjor është nëse, për shembull, ligji ndërkombëtar mjedisor është ligjërish i detyrueshëm për institucionet publike dhe organet juridike, në rast se një thyerje e të drejtave mjedisore e përfshirë në konventat relevante duhet përgjigjur nga sistemi i drejtësisë. Një përgjigje e prerë për këtë pyetje kërkon një analizë teorike të temës, gjë që kalon qëllimin e këtij dokumenti. Megjithatë, duhet të përmendet që nga pikëpamja ligjore Kosova nuk është pjesë e asnjë instrumenti ndërkombëtar të përmendur në Kornizën Kushtetuese. Nuk është ndërmarr ratifikimi nga legjislativi ashtu që nuk ka legjitimitet kushtetues për të mundësuar zbatimin e traktateve ndërkombëtare në fjalë. Përfshirja e përgjithshme e instrumenteve ndërkombëtare le një pikëpyetje të hapur sa i përket aplikimit të tyre të detyrueshëm në sistemin ligjor. Për shembull, një gjykatës lokal lirisht mund të refuzojë aplikimin e Nenit të 10 (liria e shprehjes) të KNDNJ duke u bazuar në faktin se kjo konventë nuk është e ratifikuar nga autoritetet vendore. Struktura aktuale kushtetuese dhe paqartësitë juridike të cilat mund të dalin si pasojë e zbatimit të traktateve ndërkombëtare mund të pengojnë organet administrative dhe juridike për aplikimin dhe zbatimin e normave ndërkombëtare. E njëjta vlen për të gjitha normat e mjedisore ndërkombëtare e në veçanti për Konventën e Aarhusit. Kosova ende nuk e ka ratifikuar Konventën Aarhus dhe ky fakt e len çështjen pak si të hapur posaqërisht sa i përket karakterit të detyrueshëm ligjor të Konventës në sistemin ligjor të Kosovës. Ashtu si është tani sistemi ligjor, një detyrim ligjor për respektimin e parimeve të Konventës Aarhus mund të bëhet vetëm duke u thirrur në Kartën III të Kornizës Kushtetuese e cila siguron aplikim të drejtëpërdrejtë të të gjithë instrumenteve ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Konventa Aarhus është një instrument i tillë, zbatimi i plotë i të cilit mund të bëhet nga aspekti ligjor.

### 3.2 Ligji për Qasje në Dokumentet Zyrtare

Para se të hulumtojmë aspektin e përfshirjes së Konventës Aarhus në legjislationin mjedisor të vendit, duhet dhënë një pasqyrë e Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare i cili është relevant për këtë diskutim. Me 3 Nëntor 2003, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) promulgoi Ligjin për Qasje në Dokumente Zyrtare.<sup>27</sup> Ligji definon parimet, kushtet dhe limitimet në bazë të interesave publike apo private që kanë të bëjnë me qasjen e dokumenteve të organeve publike.<sup>28</sup> Qëllimi i këtij Ligji është të sigurojë publikim dhe zbulim i punës së organeve publike në Kosovë dhe paraqet një bazë të shëndoshë ligjore për facilitimin e të drejtave individuale për kërkimin e informatave të natyrës publike. Ligji është i gjërë dhe gjithë përfshirës dhe mbulon qasjen në informata të përgjithëshme publike. Kjo do të thotë që dispozitat e këtij Ligji mund të shfrytëzohen edhe në përcjelljen e qasjes në informata mjedisore të cilat janë pjesë e informatave publike. Të gjitha institucionet publike dhe organet qeveritare që kanë të bëjnë me çështjet mjedisore duhet ti përmmbahen Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare. Praktikisht, secili që brengoset për çështjet mjedisore mund të kërkojë informata të shkruara ose gojore (dokumente, të dhëna dhe forma tjera komunikimi) nga agjencitë relevante, dhe ka të drejtën të informohet rreth politikave mjedisore, vendim marrjes me mundësi për të ngritur pjesëmarrjen e publikut të cilat do të rrisin qasjen në informata mjedisore dhe do të kontribuojnë në ngritjen e vetëdijes mjedisore drejt një pjesëmarrje më efikase në proceset e vendim marrjes mjedisore. Organet qeveritare, nga nga tjetër, duhet tu ofrojnë palëve të interesuara informata mjedisore pa vonesë dhe të sigurojnë qasje të papenguar në informatat dhe të dhënat e kërkuara. Duke parë në këtë mënyrë, Ligji për Qasje në Dokumente Zyrtare mund të shfrytëzohet nga secili person i cili pohon se i janë shkëlur të drejtat për qasje në informacione mjedisore, qoftë nga autoritetet publike apo organet qeveritare.

Procedura për qasje në informatat e kërkuara fillon me dorëzimin e kërkesës për qasje në informata. Sipas Ligjit, autoritetet duhet ti lëshojnë aplikuesit një vërtetim për të dëshmuar pranimin e kërkesës. Kërkesa për qasje në dokumentet e kërkuara duhet të refuzohet (duke dhënë arsyet për këtë refuzim) ose të lejohet brenda 15 ditë pune nga pranimi i kërkesës. Në rast të refuzimit të plotë apo të pjesërishtëm aplikuesi, brenda 15 ditë pune pas pranimit të përgjigjtjes nga institucioni, mund të dorëzojë një aplikim

<sup>27</sup>Ligji për Qasje në Dokumente Zyrtare mund të gjindet në format Ëord në: [www.unmikonline.org](http://www.unmikonline.org)

<sup>28</sup> Pjesa 1 e Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare

konfirmues ku kërkon nga institucioni ta rishqyrtojë edhe njëherë vendimin e vet.<sup>29</sup> Një procedurë afërsisht e njejtë vlen edhe kur dorëzohet aplikimi konfirmues, ashtu si përshkruhet në nenin 9 të Ligjit për Qasje në Dokumentet Zyrtare. Kjo nënkupton që brenda 15 ditë pune nga pranimi i kërkesës konfirmuese, institucioni duhet ose të lejoj qasjen ose të refuzoj qasjen në formë të shkruar duke dhënë arsyet për refuzimin e kërkesës konfirmuese. Në rast të refuzimit autoriteti publik duhet të njoftojë aplikuesin me mundësitë ligjore që atij/asaj i janë në dispozicion, gjejmësisht institucionet për procedim ligjor kundër autoritetit në fjalë, në bazë të ligjit ose në dorëzimin e ankesës pranë Ombudspersonit (përfshirë në Kapitullin 10 të Kornizës Kushtetuese dhe Rregullores së UNMIK 2000/38).

---

<sup>29</sup> Pjesa 6 e Ligjit për Qasje në Dokumete Zyrtare

### 3.3 Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit<sup>30</sup> Nr. 2002/08

Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit është aprovuar më 15 Prill 2003. Ai paraqet një kornizë ligjore të rëndësishme e cila synon të promovoj arritjen e mjedisit të shëndoshë në Kosovë nëpërmes sjelljes graduale të standardeve mjedisore të vendosura nga Bashkësia Evropiane në legjislacionin e saj. Për të arritur këtë objektivë, në Ligj janë dizajnuar një numër instrumentesh ligjore që mundësojnë zbatimin e ligjit në Kosovë dhe sigurojnë promovim efikas të mjedisit të shëndoshë. Parimi i qasjes në informata, si është paraqitur në Konventës ne Aarhusit, ofrohet në mënyrë specifike edhe në Nenin 5 (m) të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit ku çdonjërit i lejohen qasje në informata mjedisore. Aty thuhet që “të gjithë kanë të drejtë të përgjithëshme të informohen për gjendjen e mjedisit”. Ligji më tutje siguron që informatat mjedisore relevante mbi procedurat dhe aktivitetet e autoriteteve publike dhe operatorëve të shërbimeve publike që ofrojnë shërbime publike në fushën e mjedisit duhet të jenë të hapura për të gjithë publikun.<sup>31</sup> Me rëndësi të veçantë këtu është edhe qasja në informata mjedisore e cila ofrohet në një mënyrë të përgjithëshme – në formë të parimit udhëheqës të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit. Kjo nënkupton që kërkesat specifike të dalin nga Neni 4 dhe 5 i Konventës Aarhus janë të inkuorpuara në parimin për qasje të përgjithëshme në informata, sipas Nenit 5(m) “deri në atë masë që kjo mund të kërkohe apo autorizohet në mënyrë specifike nga autoriteti publik me anë të ligjit aktual apo të ndonjë akti nënligjor të dalë nga ky ligj”, apo me qëllim të zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, dhe akteve tjera nënligjore që dalin nga ky ligj.

Me rëndësi të veçantë për aspektin e pjesëmarrjes së publikut është kërkesa për të publikuar procesin e vendim marrjes gjatë Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (këtu e tutje VNM). Ligji siguron që Ministria e Mjedisit përmes Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit, duhet të publikojë çdo vendim paraprak për pëelqimin mjedisor në një periudhë prej 30 ditësh nga data e shpalljes. Kjo u jep qytetarëve një mundësi për të rishqyrtuar draft vendimin e VNM dhe të japin mendimin e tyre sa i përket gjendjens së mjedisit, i cili natyrisht që duhet, të mirret parasysh gjatë marrjes së vendimit përfundimtar për VNM. Me Nenin 21 të Ligjit dhe mundësinë që këtu u ipet qytetarëve për të shqyrtuar vendimin e VNM, duket sikur janë përmbushur kërkesat e Nenit 5.1 (b) të Konventës së Aarhusit për sigurimin e sistemeve mandatore që do të mundësonin rrjedhë adekuate të

<sup>30</sup> Ligji është nxjerrë me Rregulloren e UNMIK 2003/09.

<sup>31</sup> Neni 5 (m) i Rregullores së UNMIK 2003/09 për Mbrojtjen e Mjedisit

informatave tek autoritetet publike mbi aktivitetet ekzistuese dhe të planifikuara të cilat ndikojnë në mjedis. Duhet poashtu të përmendet që Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit përmban edhe një kapitull të veçantë mbi monitorimin mjedisor, i cili lidhet ngushtë me të drejtat për qasje në informata mjedisore. Duke ditur përgjegjësitë e Ministrisë, përkatësisht AKMM duke monitoruar gjendjen e mjedisit, ka obligim ligjor për të mbledhur dhe grupojë të dhëna dhe tregues tjerë mjedisor<sup>32</sup> të cilë t'pas ruajtjes në Sistemin Informativ për Mbrojtjen e Mjedisit duhet të bëhen publike përmes mediave dhe mënyrave tjera të informimit publik.<sup>33</sup> Këto dispozita janë në pajtim me kërkesat e Aarhusit, ku kërkohet që secili vend anëtar brenda kornizave të legjislacionit vendor, të bëjë publike informat mjedisore në një mënyrë transparente dhe efektive, *inter alia*, duke vendosur struktura praktike, si janë listat e hapura për publikun, regjistrat apo dosjet për përdorim të autoriteteve publike dhe qytetarëve nën kushtet e përcaktuara më ligj.

Në këtë kontekst duhet të përmendet që autoritetet ligjëbërëse në Kosovë kanë dështuar në adresimin e pjesëmarrjes së publikut brenda Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit. Ligjit i mungon parimi i përgjithshëm udhëheqës i cili do të nënkuptonte të drejtën e qytetarit për të marrë pjesë në procedurat e vendim marrjes në fushën e mjedisit. Praktikisht, në ligjin aktual të gjitha aspektet e ndërlidhura me Nenin 6 të Konventës Aarhus (me përjashtim të procedurave vendim marrëse në VNM) kanë mbetur pa përgjigje. Ligji nuk ofron korniza normative për procedurat që ndërlidhen me pjesëmarrjen e publikut, me qëllim që të mundësohet dorëzimit të komenteve në dëgjime publike, qoftë në formë të shkruar apo formë tjetër, të cilat mund të jenë relevante për një çështje të caktuar. Ai poashtu nuk përmban dispozita për një kornizë të drejtë dhe transparente në çështjet mjedisore. Këto kërkesa të Konventës Aarhus duhet të gjejnë vendin e tyre në ligjin aktual për Mbrojtjen e Mjedisit me qëllim të mundësimin të pjesëmarrjes publike në procedurat e vendim marrjes në fushën e mjedisit.

Është me rëndësi të theksohet që ligji nuk i referohet në mënyrë të veçantë qasjes së palëve të ndikuara në drejtësi sa i përket informatave mjedisore. Ai më shumë jep një qasje të përgjithësuar dhe inklusive për të mundësuar palët e dëmtuara të kërkojnë drejtësi prej organeve administrative dhe juridike për theyrjet e pretenduara të legjislacionit mjedisor. Kjo do të thotë se çdo për shkelje e Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit e

<sup>32</sup> Të dhënat dhe treguesit tjerë mjedisor, përfshirë edhe ndotjen dhe ngarkesat mjedisore, rrezatimin jonizues dhe jo jonizues si dhe substancat tjera të rrezikshme në ajër, në ujë, tokë, biodiversitet, flora fauna dhe atmosferën klimatike.

<sup>33</sup> Neni 35 i Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit

cila mund të ndodh, palët e ndikuara kanë të drejtë të dorëzojnë një ankesë pranë organeve përkatëse juridike dhe administrative. Kjo është shprehur qartë në Nenin 5(1) të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit. Sipas tij çdo person apo ndërmarrje e cila pretendon të ketë pësuar dëm material apo të përballlet me kërcënime serioze si pasojë e një aktiviteti të ndonjë burimi të caktuar të ndotjes (i cili thuhet të ketë shkelur legjislacionin mjedisor), lejohet të kërkojë ndihmë nga organet administrative dhe juridike.

Kjo në përgjithësi është në pajtim me Nenin 9 të Konventës Aarhus ku secila palë duhet që, brenda kornizës së legjislacionit nacional të sigurojë që secili person i cili konsideron që kërkesa e tij për informacion nuk është shqyrtuar si duhet apo në pajtim me kërkesat ligjore ka të drejtë ti drejtohen një trupi juridik të pavarur dhe të paanëshëm.

Sa i përket procedurës, Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit referohen në Ligjin për Procedura Administrative, ku të drejtat dhe përgjegjësitë e palëve të involvuara si dhe procedura e shqyrtimit administrativ janë përshkruar më detalisht. Kjo poashtu do të thotë që Ligji për Qasje në Dokumente Zyrtare mund të përdoret për të mbuluar aspektin e qasjes në informata mjedisore por jo edhe atë të pjesëmarrjes publike. Në parim ankesa duhet bërë më shkrim dhe duhet dorëzuar në bazë të termeve të përcaktuara me Ligj. Ankuesi duhet të shënoj të gjitha pikat relevante për zgjidhjen e kontestit mjedisor. Parimi i pavarësisë, barazisë gjuhësore, administrimit të dëshmimeve dhe vërtetësia e materialeve duhen poashtu të mirren parasysh nga organi administrativ gjatë shqyrtimit administrativ. Këtu është me rëndësi të ceket se procedura ligjore për thyerjen e të drejtave mjedisore mund të përcillet në tri nivele të shqyrtimit ligjor. Niveli i parë i shqyrtimit të ankesës kryhet dhe vendoset nga autoritetet lokale (p.sh inspektori mjedisor lokal).<sup>34</sup> Si rregull, ky fillon me dorëzimin e një ankese administrative te agjencia relevante në nivel lokal apo qendror. Në rast se ankuesi është ende i pakënaqur me vendimin e organit të nivelit të parë, atëherë një ankesë tjetër mund të dërgohen në Ministrinë e Mjedisit, ku vendimi i organit të nivelit të parë do të analizohet nga një këndvështrim substancial dhe formal. Procedura e nivelit të tretë është ajo e shqyrtimit juridik të vendimit të ministrisë, i cili kryhet nga Gjykata Supreme. Kjo procedurë mund të iniciohet nga pala vetëm pasi të jenë konsumuar të gjitha mjetet e rregullta juridike. Aplikuesi duhet të specifikojë arsyet ligjore të cilat ai/ajo mendon se janë shkelur nga agjencitë administrative në lidhje me qasjen e kërkuar në informata mjedisore apo të drejtat substanciale mjedisore që i janë

<sup>34</sup> Neni 47 para. 1 Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit

shkelur në vendimin e agjencisë administrative. Sidoqoftë, vendimi i Gjykatës Supreme është final dhe i pandryeshueshëm nga aspekti juridik.

Ligji për procedime administrative siguron që do të ketë procedura të drejta, në kohë të duhur dhe të barabarta ashtu që pala të mund të shërbehet me këto të drejta. Vendimi i trupave administrativ janë në dispozicion publik cka siguron pajtim me dispozitat e nenit 9 paragraf 4 dhe 5 të Konventës Aarhus.

Shikuar në kontekst të përgjithshëm vërehet se Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit ofron një platformë të shëndoshë për mbrojtjen e të drejtës në qasje në informata mjedisore ai dhe të ashtuquajturat të drejta substanciale mjedisore, në të cilat thirret Konventa e Aarhusit. Si u tha më lartë, parimi i pjesëmarrjes publike duhet të inkorporohet në ligj në pajtim me Konventën Aarhus me qëllim të mundësimit të pjesëmarrjes publike në procesin e vendim marrjes mjedisore.

### **3.4 Ligji për Mbrojtjen e Ajrit Nr. 2004/30**

Një pjesë e rëndësishme e legjislacionit është poashtu edhe Ligji nr.2004/30për Mbrojtjen e Ajrit. Ligji u nxorr me Rregulloren e UNMIK 2004/48 dhe hyri në fuqi më 25 Nëntor 2005. Ky Ligj vendos bazën juridike për rregullimin e kualitetit të ajrit. Ai poashtu përcakton të drejtat dhe obligimet e secili akter me qëllim të sigurimit të ajrit të pastër për të mbrojtur shëndetin njerëzor, faunën, florën, dhe vlerat natyrore e kulturore të mjedisit të Kosovës.<sup>35</sup> Për të arritur objektivën kryesore, Ligji për Mbrojtjen e Ajrit ka paraparë një numër standardeve për kualitetin e ajrit, dhe kështu për një mjedis më të shëndosh, që do të vrojtohen nga organet qeveritare. Me Ligj, Qeveria e Kosovës sipas propozimeve të MMPH është e obliguar të aprovojë standardet për shkarkime në ajër, duke pasur parasysh Standardet e Bashkësisë Evropiane dhe OBSH për kualitetin e ajrit.<sup>36</sup> Ligji poashtu parasheh që të gjithë personal natyror dhe juridik (me origjinë vendore apo të huaj) duhet të pajisen me leje mjedisore për ndërtimin apo shfrytëzimin e burimeve ndotëse, gjatë implementimit të projekteve që involvojnë teknologji të reja dhe produkte për prodhimin e burimeve të ndotjes, ndryshimin e standardeve dhe normave teknike për shkarkim të gazrave në ajër nga burimet e ndryshme ndotëse, në rastet kur ato rrezikojnë mbrojtjen e ajrit: edhe prodhimi, importimi, dhe tregtia me karburante, pajisje

<sup>35</sup> Neni 1 i Ligjit Nr.2004/30 për Mbrojtjen e Ajrit

<sup>36</sup> Neni 6 i Ligjit Nr.2004/30 për Mbrojtjen e Ajrit

të fiksuara, materiale dhe produkte të cilat mund të ndotin ajrin, etj.<sup>37</sup> Mirëpo duhet cekur që sa i përket qasjes në informacione, Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nuk përfshin asgjë. Ligji vetëm siguron njoftimin e ndotjes së ajrit nga autoritetet publike por nuk i referohen në mënyrë eksplicite të drejtës së palëve për të pasur qasje në informatat dhe të dhëna relevante për kualitetin e ajrit. Sipas Nenit 16 të Ligjit, ' të gjithë operatorët që shkarkojnën ndotës obligohen të publikojnë të dhënat e tyre mbi ndotjen e ajrit dhe të dorëzojnë informata të plota periodike në MMPH'. Në këtë mënyre secili qytetar i brengosur për kualitetin e ajrit mund t'i afrohet MMPH drejtpërsëdrejti duke dorëzuar një kërkesë për qasje në informata të tilla, jo bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Ajrit por bazuar në Ligjin për Qasje në Dokumente Zyrtare apo Kornizen Kushtetuese, e cila thirret në aplikimin e instrumenteve ndërkombëtare për drejtat e njeriut, dhe të cilat duhet të respektohen nga autoritetet publike. Vetëm në rastet e ndotjes ekstreme dhe smogut, MMPH është e obliguar të informojë publikun nëpërmes mediave ashtu që informata shpërndahet drejt për drejtë te publiku i gjerë. Është për t'u dyshuar nëse dispozitat e përfshira në këtë ligj janë të mjaftueshme për të përmbushur kërkesat e Aarhusit. Duke pasur parasysh ndërlikueshmërinë e kësaj çështje, nuk është e paarsyeshme të thuhet se nevoja për informata lidhur me ndotjen e ajrit nuk është e rëndësishme vetëm për demokracinë mjedisore por është një kërkesë qytetare, gjithnjë në rritje, ndaj të cilës çdo shoqëri duhet të reagojë me instrumente ligjore dhe teknologji informative.

Duket sikur kërkesat dhe kushtet e Konventës së Aarhusit nuk janë përfshirë në mënyrë substanciale dhe gjithëpërfshirëse në Ligjin aktual. Duke pasur parasysh rëndësinë e kësaj çështjeje dhe përpjekjet e mëdha për të ndritur vetëdijën rreth ndotjes së ajrit, është dashur që hartuesit juridik të këtij Ligji ti kushtojnë shumë më shumë rëndësi sigurimit të strukturave të mjaftueshme ligjore sa i përket qasjes në informata, përkatësisht në të dhëna mbi ndotjen e ajrit. Vlerësim i njejtë mund të ipet edhe sa i përket përfshirjes së pjesëmarrjes publike në Ligjin për Mbrojtjen e Ajrit. Kërkesa e Konventës së Aarhusit për promovimin e pjesëmarrjes publike efikase gjatë përgatitjes së rregullave të detyrueshme ligjore (të cilat mund të kenë ndikim të madh në mjedis) nga autoritetet publike nuk mund të përceptohet në Ligjin aktual. Gjatë procedurës së marrjes së lejes mjedisore për aktivitetet që ndotin ajrin, Ligji do të duhej të siguronte instrumente ligjore që mundësojnë publikur për të dhënë mendimin e vet sa i përket

<sup>37</sup> Neni. 16 Ligjit Nr.2004/30 për Mbrojtjen e Ajrit



aktiviteteteve të planifikuara në zonat e banuara.<sup>38</sup> Është e nevojshme për mbrojtjen e personave të cilëve ju shkaktohen dëme materiale nga emisionet e ndotjes në ajër nga burimet stacionare, që autoritetet të cilat lëshojnë leje mjedisore në këtë rast të mbajnë sesione publike (në bazë të iniciativës vetanake ose si kërkesë e ndonjë pjesëmarrësi në procedurë) dhe që mendimet e qytetarëve dhe institucioneve në fjalë të mirren parasysh gjatë marrjes së vendimit për lëshimin e lejes mjedisore për aplikantin. Kjo është një ndër kërkesat kryesore të Konventës së Aarhusit dhe duhet të inkorporohet në Ligjin për Mbrojtjen e Ajrit.

### 3.5 Ligji i Ujërave Nr. 2004/24

Ligji i Kuvendit të Kosovës për Ujëra u nxorr me Rregulloren e UNMIK Nr. 2004/41. ky Ligj rregullon çështje si menaxhimi, planifikimi, mbrojtja dhe përgjegjësi institucionale sa i përket ujërave dhe resurseve ujore. Ligji i Ujërave synon të sigurojë zhvillimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve ujore, të nevojshme për shëndetin e njeriut, mjedisin dhe zhvillimin socio ekonomik të Kosovës. Ai poashtu përpiqet të sigurojë mbrojtjen e resurseve ujore nga ndotja, tejeksplotimi dhe keqtrajtimi. Për të siguruar përputhje mes dispozitave ligjore dhe sigurimit të shfrytëzimit të qëndrueshëm të resurseve ujore, Ligji ka vendos një sërë parimesh fundamentale për menaxhimin e ujërave, të cilat duhet të respektohen nga autoritetet relevante publike gjatë menaxhimit të ujërave. Edhe përkundër parimeve tjera shumë të rëndësishme të vendosura nga Ligji për Ujëra, në kontekst të këtij raporti parimet më të rëndësishme mbasin pjesëmarrja publike dhe qasja në informata, si dhe afirmimi i parimit për involvimin e palëve të interesuara. Vlen të lexohet definomi i parimeve përkatëse në tërësi, i cili kryesisht është i përpiluar shumë ngashëm me Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit. ‘Publiku duhet të ketë qasje në të gjitha informatat lidhur me vendimet rreth menaxhimit të ujërave dhe resurseve ujore si dhe duhet të ketë mundësi të marr pjesë në marrjen e vendimeve’ janë fjalët e shënuara në Ligj.<sup>39</sup> Ligji poashtu siguron ‘që autoritetet kompetente janë të obliguara të marrin parasysh dhe të ruajnë interesat e të gjitha palëve të involvuara në procesin e vendim-marrjes’.<sup>40</sup> Duke e parë këtë formulim shihet se hartuesit e këtij ligji kanë qenë mjaft të hapur kundrejt parimeve të Konventës së Aarhusit, duke demonstruar një përkushtim të fortë për vlerat dhe parimet të cilat synon ti sjellë Aarhusi.

<sup>38</sup> Ligji Nr.2004/30 për Mbrojtjen e Ajrit, Neni 17

<sup>39</sup> Ligji i Ujërave, Neni 5 (h)

<sup>40</sup> Ligji i Ujërave, Neni 5 (i).

Megjithatë, ligji në fjalë nuk përcakton procedurat dhe mekanizmat konkret. Në të vërtetë parimi për qasje në informata dhe pjesëmarrje publike janë përfshirë në mënyrë të përgjithësuar. Një rregullore tjetër e detajzuar, si akt nënligjor i dal nga ky ligj do të të përcaktojë procedurat më saktësisht në pajtim me Ligjin e Ujërave.

Sa i përket Ligjit të Ujërave është relevante të bëhen disa komnete në lidhje me përfshirjen e parimit për qasje në informata. Si u tha parimi i qasjes në informata rreth menaxhimit të ujërave dhe resurseve ujore sigurojnë një kornizë të përshtatshme për të mundësuar pranimin dhe shpërndarjen e informatave relevante për qytetarët. Përfshirja e parimit për qasje në informata përbush kërkesat e Konventës së Aarhusit, e cila e vendos kërkesën për qasje në informata si obligim fundamental të cilin duhet ta përbushin autoritetet nacionale. Përkundër Ligjit për Mbrojtjen e Ajrit, parimi për qasje në informata jo vetëm që zë një vend të rëndësishëm në Ligjin e Ujërave, por këtu një pjesë e veçant i dedikohet themelimit të Sistemit Informativ të Ujërave, ku do të ruheshin, përpunoheshin dhe viheshin në dispozicion të publikut informatat mbi të gjitha aktivitetet dhe masat e lidhura me regjistrimin, transferin dhe mbrojtjen e të dhënave relevante për menaxhimin e ujërave, ashtu si edhe është përcaktuar nga Ligji.<sup>41</sup> Edhe sfera e të dhënave në të cilët qytetërëve ju lejohet qasje duket të jetë mjaft e gjërë. Kjo përfshin të dhëna mbi kualitetin dhe kuantitetin e ujërave; gazetën e ujërave dhe sistemin e regjistrave të ujit; regjistrin e të gjitha lejeve ujore; regjistrin e substancave të shkarkuara nga poseduesit e lejeve ujore; masat për rehabilitim dhe programet për mbrojtjen e ujërave; incidente të dëmtimit të ujërave dhe aksidentet mjedisore; regjistrat e materialeve të dëmshme dhe të rrezikshme në resurset ujore; aktivitetet e dëmshme ër shëndetin e njeriut dhe për mjedisin; analizat e ndikimeve të materialeve të rrezikshme; dhe regjistrin e informatave mbi ndërtimin, instalimin apo ekzistimin e deponive të rrezikshme. Neni 6.1 i Ligjit kërkon që autoritet publike që ato të vënë në dispozicion të publikut të gjitha informatat lidhur me menaxhimin e ujërave dhe resurseve ujore përveç atyre të cilat shpallen si informata sekrete. Ligji më tutje përcakton se çështjet praktike rreth Sistemit Informativ të Ujërave do të rregullohet me akte ligjore dytësore, të cilat Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) duhet t'i nxjerrë jo më larg se në Tetor 2006. Duke pasur parasysh ndjeshmërinë e të dhënave dhe duke vërejtur shumëllojshmërinë e informatave që do të jenë në dispozicion të publikut, është e domosdoshme që Ministria të adresojë hartimin e ligjeve dytësore për rregullimin e Sistemit Informativ të Ujërave, me një urgjencë të jashtëzakonshme, ashtu që të gjitha

<sup>41</sup> Neni 61 i Ligjit të Ujërave

aspektet praktike dhe rregullat procedurale për të ngritur qasjen e publikut në informata të fushave dhe dosjeve të caktuara të jenë detajizuar në masë të mjaftueshme. Qasja në informata forcohet edhe më shumë në këtë Ligj përmes sigurimit të Gazetës së Ujërave, e cila do të ishte një evidencë zyrtare a të gjitha lejeve ujore dhe pajtimeve ujore.<sup>42</sup> Gazeta Ujore do të nxirret nga autoriteti i lejeve ujore dhe do të përmbajë regjistrin e dekomuntacioneve teknike, kopjet e të cilave duhet të dorëzohen në Autoritetet Rajonale të Pellgjeve Lumore për tu regjistruar në Sistemin Informativ të Ujërave.<sup>43</sup>

Njësoj si qasja në informata edhe parimi 'Aarhus' për pjesëmarrjen publike ka gjetur vendin e tij në këtë Ligj. Si u tha më parë Ligji afirmon pjesëmarrjen publike nën të cilën qytetarëve duhet dhënë mundësi e mjaftueshme për të marrë pjesë në procesin e vendim marrjes rreth menaxhimit të ujërave dhe resurseve ujore. Neni 5 i Ligjit kur flet për menaxhimin e qëndrueshëm të ujërave siguron që publiku duhet të ketë të gjitha informatat sa i përket vendimeve rreth Menaxhimit të Ujërave dhe Resurseve Ujore si dhe duhet të ketë mundësi të marr pjesë në këto vendime. Si mund të shihet, parimi i pjesëmarrjes publike është përfshirë në një kontekst më gjithëpërfshirës dhe të përgjithshëm gjë që nënkupton komunikimin aktiv mes autoriteteve publike dhe qytetarëve në procesin e vendimmarrjes sa i përket menaxhimit të ujërave dhe resurseve ujore. Ligji shkon edhe më tutje dhe siguron që dokumentet themelore për planifikimin dhe zhvilliminin e menaxhimit ujqor poashtu duhet t'i nënshtrohet diskutimeve publike.<sup>44</sup> Me përjashtim të planit për mbrojtje nga vërshimet, zhvillimi i Planit Strategjik të Ujërave, Plani për Menaxhimin e Ujërave dhe Planet për Menaxhimin e Pellgjeve Lumore kërkojnë përfshirje publike aktive para se të finalizohen. Ligji siguron që secili autoritet i cili propozon planin duhet të informojë publikun tri (3) vite para se të fillojë procesin e hartimit, duke siguruar kështu pjesëmarrje aktive dhe me kohë gjatë hartimit.<sup>45</sup> Para se të fillojë procesi i hartimit, autoritetet relevante duhet të sigurojnë që të gjitha palët relevante qeveritare nga qeveritië lokale dhe qendrore, organizatat jo-qeveritare, mbajtësit e të drejtave ujore, dhe palët tjera të interesuara kanë pasur mundësi itë mjaftueshme për të kontribuar në përgatitjen e planit në fjalë. Pasi të ketë përfunduar procesi i hartimit, palët e involvuara do të kenë edhe një mundësi të dhënë

<sup>42</sup> Neni 62 i Ligjit të Ujërave

<sup>43</sup> Ligji i Ujërave Neni 62 para. 4

<sup>44</sup> Ligji i Ujërave Neni 64

<sup>45</sup> Ligji i Ujërave, Neni 64 para. 2

komentet e tyre mbi draftin e përgatitur, në periudhë prej 6 muajsh nga data e shpalljes.<sup>46</sup>

### 3.6 Ligji për Administrimin e Mbeturinave <sup>47</sup>

Ligji për Mbeturina është aprovuar nga Kuvendi i Kosovës më 22 Qershor 2005. Ai vendos kornizën juridike për punën me mbeturina dhe synon të mbrojë shëndetin njerëzor dhe mjedisin nga ndotja dhe rreziku prej mbeturinave, duke arritur një menaxhim të mirëfilltë mjedisor të mbeturinave dhe duke vendosur kushtet për parandalimin dhe redukimin e prodhimit të mbeturinave dhe dëmeve nga mbeturinat.<sup>48</sup> Si vijim i dispozitave fillestare, Ligji përcakton një numër parimesh për menaxhimin e mbeturinave që duhet të përcillen nga autoritetet manaxhuese. Ligji poashtu flet edhe për llojet e mbeturinave dhe karakterizimin e mbeturinave dhe vendos kornizën normative për dokumentet e planifikimit të menaxhimit të mbeturinave. Ligji përmban dispozita sa i përket organizimit dhe funksionimit të autoriteteteve për menaxhimin e mbeturinave si dhe për aktivitetet e menaxhimit të mbeturinave. Sa i përket raportimit dhe regjistrat të bazës së të dhënave të menaxhimit të mbeturinave, Ligji siguron mundësinë që secila komunë të raportojë rreth zbatimit të planeve lokale për menaxhimin e mbeturinave. Regjistrat e bazës së të dhënave, si përcaktohet nga Ligji duhet të të përmbajnë informata mbi llojin, karakteristikat, sasinë dhe klasifikimin e mbeturinave, objektet për mbeturina, licensimin e menaxhimit të mbeturinave, licensimin e objekteve për menaxhimin e mbeturinave si dhe informata tjera relevante për menaxhimin e mbeturinave. Për ndryshim nga ligjet e elaboruara më parë, Ligji i Kuvendit të Kosovës për Mbeturina i referohet qartë dhe drejtpërdrejt Konventës së Aarhusit sa i përket qasjes në informata dhe qasjes në drejtësi. Neni 5 para.8 i Ligjit (parimi për qasje të publikut në informacione) siguron që të gjithë personat natyror dhe juridik kanë të drejtën, pa pasur nevojë të dëshmojnë një interes special, të kenë qasje në të gjitha informatat që kanë të bëjnë me aktivitetet për menaxhimin e mbeturinave “në pajtim me parimet e Konventës së Aarhusit”. Përderisa Ligji nuk përmban një kalpitull të veçantë për qasjen në informata, afirmimi i parimit për qasje në informata duke ju referuar në mënyrë eksplicite Konventës së Aarhusit ofron një instrument të përshtatshëm i cili

<sup>46</sup> Ligji i Ujërave Neni 64 para. 6

<sup>47</sup> Ligji për nënshkrimin e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për të hyrë në fuqi.

<sup>48</sup> Neni 1 i Ligjit për Mbeturina

siguron kornizë të mjaftueshme normative për transparencë në aktivitetet e krijimit të politikave dhe vendim marrjes në menaxhimin e mbeturinave, si dhe qasje të sigurtë në të dhënat për aktivitetet dhe autoritetet e menaxhimit të mbeturinave. Ligji përcakton qartë standardet e Aarhusit për qasje në informata të cilat duhet të përcillen nga autoritetet vis-à-vis personave natyrorë dhe juridik.

Ligji poashtu udhëhiqet nga parimi për mbrojtjen e të drejtave në para gjykatave – cka në të vërtetë paraqet parimin për qasje në drejtësi, si është përfshirë në Konventën e Aarhusit. Parimi apo obligimi ligjor përkatës siguron që secili person i cili deklaron të jetë lënduar apo dëmtuar gjatë aktiviteteteve të menaxhimit të mbeturinave ka të drejtë ti drejtohet gjykatës. Ligji nuk i referohen në mënyrë direkte Nenit 9, paragraf 1 dhe 2 (refuzimit të qasjes në informata) të Konventës Aarhus por mjaft mirë i mbulon kërkesat e Nenit 9, paragraf 3, kur bëhet fjalë për të drejtën e publikut në procedura administrative dhe juridike me qëllim të sfidimit të akteve të pengimit nga personat privat apo autoritetet publike të cilat veprojnë në kundërshtim me dispozitat e ligjeve mjedisore të vendit. Gjuha e përdorur është gjithëpërfshirëse dhe në pajtim me kërkesat e Konventës së Aarhusit për qasje në drejtësi. Ajo thjesht ofron mundësi për tu ankuar tek gjykata kompetente në rast të pretendimit të shkeljes së të drejtave mjedisore si pjesë e aktiviteteteve për menaxhimin e mbeturinave. Ky sigurisht është parimi i përgjithshëm i qasjes në drejtësi mjedisore dhe do të elaborohet më tutje me rregullore ku do të përshkruhen dhe rregullohen më detalisht të gjitha çështjet rreth shqyrtimit të ankesave të dorëzuara.

Çuditërisht, Ligji për Mbeturina nuk përmend pjesëmarrjen publike në vendim marrje. Parimi për pjesëmarrje publike si pjesë e Konventës së Aarhusit (Neni 7) duket sikur nuk është adresuar sa duhet në Ligjin aktual. Për shembull, Ligji siguron hartimin e dokumenteve për planifikimin e menaxhimit të mbeturinave nga autoritetet kompetente lokale apo qendrore. Gjatë hartimit të planeve lokale për menaxhimin e mbeturinave, ligji siguron përfshirjen dhe konsultimin e përfaqësuesve të ofruesve të shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave, asociacioneve të ndryshme ekonomike, dhe përfaqësuesve të organizatave joqeveritare si dhe institucioneve profesionale por dështoi në parashikim e pjesëmarrjes publike gjatë hartimit të dokumenteve për planifikimin e menaxhimin e mbeturinave. Duke pasur parasysh rëndësinë e aktiviteteteve për menaxhimin e mbeturinave, një pjesëmarrje e gjerë e publikut në përpilimin e dokumenteve dhe

programeve lidhur me menaxhimin e mbeturinave do të përmbushte kërkesat e Nenit 2 të Direktivës 2003/35/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit që siguron se në vendet anëtare “publikut duhet ti ipen mundësi të hershme dhe efikase për të marr pjesë në përgatitjen dhe modifikimin apo shqyrtimin e planeve ose programeve që kërkohet të përgatiten ashtu si janë listuar në Shtojcën I” Direktiva e Këshillit, 12 Dhjetor 1991 për Mbeturinat e Rrezikshme (91/689/EEC) si është amendamentuar herën e fundit me anë të Direktivës 94/31/EC. Përputhshmëria e Ligjit të Mbeturinave me Nenin 7 të Konventës Aarhus dhe me Direktivën 2003/35/EC, (qëllimi i të cilës është të kontribuojë në përmbushjen e obligimeve që dalin nga Konventa e Aarhusit), është me rëndësi për mundësimin e involvimit të publikut të gjerë gjatë dizajnit të dokumenteve strategjike dhe programeve për menaxhimin e mbeturinave në pajtim me legjislacionin dhe praktikatat relevante të BE-së.

### 3.7 Ligji për Mbrojtjen e Natyrës<sup>49</sup>

Ligji për Mbrojtjen e Natyrës është hartuar nga MMPH dhe është aprovuar nga Kuvendi i Kosovës me 23 Mars 2005. Ligji vendos kornizën juridike për mbrojtjen e natyrës në Kosovë. Ai definon nocionet dhe parimet për mbrojtjen e natyrës dhe përcakton rregullat dhe procedurat për mbrojtjen e vlerave natyrore. Përveç kësaj Ligji synon të revitalizoj zonat e dëmtuara natyrore, ruajtjen e balancit ekologjik në natyrë dhe parandalimin e eksploatimit të vlerave natyrore dhe florës dhe faunës të rrezikuar. Ligji do të udhëhiqet nga parimi i bashkëpunimit, qëndrueshmërisëm integrimin e parimeve për vetëdijësim publik dhe përgjegjësi ligjore duke përfshirë edhe parimin për menaxhim efikas të mbrojtjen e natyrës.<sup>50</sup> Do të shihet qartë se kërkesat për qasje në informata dhe për pjesëmarrje publike nuk janë përfshirë fare në këtë ligj të Kuvendit. Duke pasur parasysh kërkesat e Konventës Aarhus dhe duke konsideruar nevojën për të sjellë aplikim uniform të parimeve të Aarhusit në ligjet vendore, sjellja e parimeve të Aarhusit në Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës do të ishte një instrument i përshtatshëm për të mundësuar qasje në informata mjedisore dhe pjesëmarrjen publike në fushën e mbrojtjes së natyrës. Në vend se të ofrohen mundësi të qarta për qasje në informacione dhe pjesëmarrje publike dhe për të trajtuar kërkesat e Aarhusit në mënyrë të barabartë me ligjet e tjera, e drejta në informata publike dhe pjesëmarrja publike në fushën e mbrojtjes së natyrës vetëm sa

<sup>49</sup> Ligji është aprovuar nga Kuvendi me 23 Mars 2005 dhe tani pret nënshkrimin e PSSP për të hyrë në fuqi.

<sup>50</sup> Neni 6 I Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, Nr 02/L-18 (23 Mars 2005).

janë përmendur në objektivat e Ligjit.<sup>51</sup> Se a janë dispozitat për informim dhe pjesëmarrje publike, të përcaktuara me Ligj, të përshtatshme nga aspekti juridik mbetet ende mjaft e pasigurtë. Qëllimet e listuara në Ligj janë të obligueshme për institucionet publike dhe agjencitë administrative që kanë të bëjnë me mbrojtjen e natyrës mirëpo gjuha e përdorur dhe konteksti në të cilin janë vendosur këto dispozita është paksa i pamjaftueshëm dhe jo efikas për të lejuar qasje të mirëfilltë në informata mjedisore dhe për të mundësuar pjesëmarrje të gjerë publike në procesin e dizajnit të dokumenteve relevante për mbrojtjen e natyrës.

E drejta për qasje në informata është përfshirë në Nenin 35 të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës. Është një përpilim i përgjithësuar ku thuhet se publiku duhet të ketë qasje të papenguar në informatat rreth gjendjes së natyrës.<sup>52</sup> Duke rregulluar sistemin e informimit dhe publikut Ligji siguron themelimin, menaxhimin dhe funksionimin e sistemit informativ për mbrojtjen e natyrës, i cili do të jetë pjesë e Sistemit për Informim Mjedisor, si kërkohet me Nenin 37 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit. Nën Paragrafin 2 të Nenit 35, duhet të kryhet regjistrimi, pranimi dhe analizimi i të dhënave, fakteve dhe informatave rreth gjendjes së eksploatimit të natyrës, përfshirë edhe masat që janë ndërmarrë nga autoritetet relevante. Për të arritur objektivin e përmendur, Ministria e Mjedisit duhet të hartoj dhe t'i dorëzoj qeverisë, një raport vjetor i cili pasqyron gjendjen e mbrojtjes së natyrës. Është poashtu me shumë rëndësi të përmendet që qasja në informata publike sigurohet edhe gjatë përcaktimit të zonave të mbrojtura, ku duhet të lejohet qasje e papenguar në dokumentacionin përkatës. Neni 29, para. 6 i Ligjit siguron që qytetarët të kenë qasje në dokumentacionin për përcaktimin e zonave të mbrojtura 30 ditë para se të bëhet akti i përcaktimit nga autoriteti kompetent. Marrë në përgjithësi, lejimi i 30 ditëve për konsultime publike në procesin e përcaktimit të zonave të mbrojtura duket plotësisht e mjaftueshme dhe lejon kohë të mjaftueshme për të gjitha palët për tu njoftuar me përmbajtjen e dokumentacionit dhe për të shqyrtuar korrektësinë e të dhënave para së një zonë të shpallet si e mbrojtur.

Përveç qasjes në informata, Ligji për Mbrojtjen e Natyrës siguron edhe pjesëmarrjen publike në procesin e përcaktimit të zonave të mbrojtura. Sipas Ligjit një zonë shpallet me mbrojtur me qëllim të ruajtjes së biodiversitetit, peizashëve, tipareve natyror dhe

<sup>51</sup> Neni 2 (g).

<sup>52</sup> Neni 35 para. 4 Ligji për Mbrojtjen e Natyrës

trashëgimisë kulturore, e cila në pajtim me vendimin e autoritetit kompetent vendosen nën mbrojtje speciale të autoriteteve publike. Këto përfshijnë parqet nacionale, rezervatet natyrore, mounumetet natyrore, zonat e peizazheve të mbrojtura.<sup>53</sup> Shikuar nga perspektiva e pjesëmarrjes publike, Ligji siguron mundësi për pjesëmarrjen e publikut në procesin e përcaktimit të zonave të mbrojtura natyrore. Neni 31 siguron që cdo person natyror dhe juridik, mund të nis procedurën për emërtimin e një zonë si zonë të mbrojtur natyrore. Propozimet e tilla i nënshtrohen analizës nga Agjencia Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit, në bazë të cilës Ministria e Mjedisit do të vendos nëse propozimi për përcaktimin e zonës së mbrojtur është apo jo ligjërish i mundshëm.<sup>54</sup> Në këtë rast nuk mund të thuhet sigurisht nëse kërkesat e Konventës së Aarhusit (sigurimi i pjesëmarrjes publike gjatë përgatitjes së planeve dhe programeve, si dhe rregulloreve ekzekutive dhe në përgjithësi rregullave që janë juridikisht të detyrueshme dhe që kanë ndikim në mjedis) janë përmbushur plotësisht apo jo. Duke ditur rëndësinë e pjesëmarrjes publike në vendimmarrje dhe sigurimi i mundësisë për të shprehur shqetësimet në këtë drejtim, një pjesëmarrje e gjerë publike gjatë procesit të shpalljes së zonave të mbrojtura është esenciale për cdo demokraci mjedisore dhe meriton të reflektohet plotësisht në secilën pjesë të legjislacionit që ka të bëjë me mjedisin. Për këtë Ligji jo vetëm që duhet të siguroj pjesëmarrjen e publikut në procedurat e shpalljes së zonave të mbrojtura por duhet të sigurojë struktura ligjore të mjaftueshme për konsultimin e publikut para se të ndërmerret procedura për shpalljen e zonës së mbrojtur. Duke synuar pjesëmarrje të gjerë të publikut në procesin e shpalljes së zonave të mbrojtura natyrore, autoritetet publike sigurojnë që shqetësimet e qytetarëve janë marrë parasysh gjatë procedurave për shpalljen e zonave të mbrojtura natyrore. Kjo është një kërkesë që del nga Konventa e Aarhusit dhe duhet të përfshihet në të gjitha ligjet mjedisore, përfshirë edhe atë për mbrojtjen e natyrës.

---

<sup>53</sup> Neni 21 Ligji për Mbrojtjen e Natyrës

<sup>54</sup> Neni 31 Ligji për Mbrojtjen e Natyrës



#### **4. Legjislacioni mjedisor komunal**

Si përshkruhet në mënyrë shprehimore në Konventën e Aarhusit, rregullimi dhe mbrojtja e mjedisit nuk është thjeshtë një çështje vetëm e organeve të nivelit qendror. Duke pasur parasysh hartimin tekstual të autoriteteve publike, Aarhusi shënon që autoritetet publike që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit nënkuptojnë qeverinë në nivel nacional, rajonal, dhe të tjera, si dhe personat juridik që kryejnë funksione administrative sipas ligjit, përfshirë detyrat specifike, aktivitetet apo shërbimet që lidhen me mjedisin.<sup>55</sup> Shikuar nga këndvështrimi praktik, organet komunale mbesin në një pozitë shumë më të volitshme se organet e nivelit qendror. Kjo nuk ndodh vetë për arsyet të pozitës gjeografike por poasht për arsye të efikasitetit të masave të ndërmarra për qëllime të mbrojtjes së mjedisit. Duke njohur rolin vital të organeve komunale në mbrojtjen e mjedisit, Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit ka përcaktuar një numër përgjegjësish që duhet të ushtrohen nga organet komunale me qëllim të mbrojtjes së mjedisit. Këto përgjegjësi do të trajtohen në pjesën vijuese të raportit. Neni 3 i Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit kërkon që komunat të bartin përgjegjësi, deri në masën e përcaktuar nga Ligji, për çështjet mjedisore të cilat burojnë, apo ka gjasa të burojnë nga territori i komunës përkatëse, “nëse çështjet e tilla mund të trajtohen, kontrollohen, parandalohen, financohen apo menaxhohen nga vet komuna”.<sup>56</sup> Në veçanti komunave u lejohet të vendosin dhe të sigurojnë implementimin e standardeve nga furnizuesit lokal (në pajtim me legjislacionin mjedisor primar dhe sekondar), nëse çështja në fjalë nuk është nën menaxhimin e PSSP. Përveç kësaj komunat janë të pajisura edhe me mundësin për të zhvilluar instrumente planifikimi në lidhje me mbrojtjen e mjedisit në komunën përkatëse, si dhe vendosja e masave për mbrojtjen a arsyeshme të natyrës në mënyrë të bazuar në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe në përputhje me legjislacionin mjedisor primar dhe sekondar. Komunitat poashtu mund të aprovojnë masa komunale për mbrojtje e mjedisit në përputhje me legjislacionin mjedisor primar dhe sekondar.<sup>57</sup>

Ndryshe nga Sistemi Informativ për Mbrojtjen e Mjedisit, komunat poashtu mund të mbajnë evidencë (shënime) që do të përfshinte informata mbi të gjithë subjektet që ndërmarrin aktivitete të autorizuara nga ministria dhe komunat, si dhe informata mbi vet aktivitetet; aplikimin e pëlqimeve mjedisore, lejeve dhe autorizimeve tjera mjedisore të

<sup>55</sup> Konventa Aarhus, Neni 2

<sup>56</sup> Konventa Aarhus, Neni 3

<sup>57</sup> Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Neni 7 para. 3

kërkuara, si dhe informata tjera të marra nën dispozitat e ligjit. Këto shënime mund të përmbajnë edhe informata mbi gjoabat e ndara sipas ligjeve mjedisore dhe rregulloreve tjera përkatëse, direktivave apo akteve tjera normative.<sup>58</sup> Ky është me të vërtetë një instrument i rëndësishëm në shikim të kërkesave të Aarhusit për qasje në informata dhe pjesëmarrje publike, në të cilin mund të thirren qytetarët e ndonjë komune të caktuar ku një çështje mjedisore kërkon studim shumë më të afërt.

Për këtë arsye është një obligim ligjor i komunave që të sigurojnë qasje të pa pengueshme për qasje në informata mjedisore dhe për të mundësuar pjesëmarrjen publike me qëllim të mbrojtjes së mjedisit. Obligimi përkatës për pjesëmarrje publike është i shprehur qartë në Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit dhe duhet të respektohet edhe nga autoritetet lokale.

Duhet cekur se qëllimi i këtij studimi nuk është të vlerësohet se sa zbatohen nga autoritetet përgjegjëse komunale parimet e Konventës të përfshira në legjisllacionin vendor primar. Kjo do të tejkalonte kornizat e këtij raporti si dhe kërkon një qasje shumë më të thellë dhe analitike për të dhënë një gjykim të saktë mbi procesin e zbatimit të Konventës Aarhus në autoritetet komunale. Por ajo që është vërejtur gjatë përcjelljes së zhvillimeve ligjore në nivel komunal është që organet komunale në Kosovë në përgjithësi kanë qenë mjaft të ngathta në përfshirjen e parimeve të Konventës Aarhus. Me përjashtim të disa rasteve, legjisllacioni mjedisor i komunave është ende në proces të përafrimit me legjisllacionin qendror dhe aktet përkatëse të legjisllacionit ndërkombëtar për mjedis. Implimentimi i parimeve Aarhus në këtë rast sigurisht që paraqet një sfidë të madhe në përpjekjet e autoriteteve komunale për të zhvilluar legjisllacion modern. Megjithatë mungesa e legjisllacionit adekuat mjedisor në nivel komunal nuk do të thotë dështim i plotë i autoriteteve komunale për observimin e parimeve të Konventës Aarhus. Vetëdijësimi në ngritje i komunitetit mjedisor si dhe reflektimet e legjisllacionit primar mjedisor kanë nxitur shoqërinë civile dhe OJQ mjedisore të zhvillojnë fushata të qëndrueshme për ngritjen e vetëdijes rreth nevojës për përfshirjen e parimeve të Konventës Aarhus, qëllim ky i cili ndahet nga autoritetet lokale dhe qytetarët. Organizimi i debateve publike për çështjet të ndryshme mjedisore relevante për komunë apo rajon, si p.sh debati i mbajtur në Pejë për diskutimin e një plani lokal të veprimit në mjedis janë tregues i ngritjes së kuptimit të rëndësisë së qasjes në informata dhe pjesëmarrjes publike, edhe nga qytetarët edhe nga autoritet publike.

---

<sup>58</sup> Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, Neni 37 para. 3

Kur flasim për zhvillimin në nivel komunal, duhet të përmendet edhe mungesa e vetëdijës publike të qytetarit sa i përket nevojës për përcjelljen e legjislacionit mjedisor. Në takim e mbajtur më 9 Mars 2006, organizuar nga REC Zyra në Kosovë (Qendra rajonale për Mjedis), ku morëm pjesë akterë të ndryshëm nga fusha e mjedisit, pjesëmarrësit theksuan se në Kosovë mungon vetëdijësimi publik në lidhje me implementimin e ligjeve mjedisore. Përfaqësuesit e MMPH dhe komunitetit të OJQ aktive në fushën e mjedisit theksuan nevojën për të ngritur vetëdijësimin publik në lidhje me legjislacionin mjedisor dhe me kërkesat e Konventës Aarhus, si një parakusht për implementimin e suksesshem të normave dhe parimeve të tilla. Ngritja e vetëdijës është një aspekt i rëndësishëm i implementimit të legjislacionit mjedisor në Kosovë në kontekst të Konventës Aarhus. Për të arritur këtë qëllim pjesëmarrësit e këtij takimi e panë të nevojshme të organizohen një numër aktivitete të cilat jo vetëm që do të mundësonin njohjen me Konventën Aarhus dhe parimet e saj, por edhe përmirësimin e nivelit të përcjelljes së normave dhe parimeve të tilla nga autoritetet lokale të cilat do të shkonin në dobi të qytetarit. Konceptimi i përgjithshëm i fushës së të drejtave të njeriut duhet kuptuar dhe përdorur në mënyrë më efektive për të ofruar asistencë praktike me vlerë të njëjtë edhe në legjislacionin mjedisor. E njëjta mund të thuhet edhe për Konventën Aarhus zbatimin e të cilës në sytë e pjesëmarrësve ende shihet të jetë mjeft i ulët në nivel komunal.

## **5. Fakte dhe rekomandime**

Pasi është analizuar shkurtimisht masa deri në të cilën parimet e Konventës së Aarhusit janë përfshirë në legjislacionin mjedisor të Kosovës, ka disa aspekte të përfshirjes së Aarhusit në legjislacionin ekzistues mjedisor që ende mbeten të paqarta. Në përgjithësi mund të thuhet se, me përjashtim të disa rasteve, kërkesat e Aarhusit për qasje në informata, pjesëmarrje publike dhe qasje në drejtësi mjedisore në përgjithësi janë inkorporuar në ligjet vendore aktuale. Duke filluar nga Ligjet të cilat përmbajnë referenca të drejtpërdrejta në Konventën e Aarhusit (si p.sh Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ligji i PK për Mbeturina), pjesë tjera të legjislacionit në një mënyrë, apo në një tjetër, përmbajnë parimet e Aarhusit, duke siguruar kështu elemente të mjaftueshme ligjore për të mundësuar qasjen në informata, pjesëmarrjen publike si dhe qasjen në drejtësi. Përafrimi i ligjeve nacionale të Kosovës me parimet e Konventës Aarhus, dëshmon se këtë rregulla nuk shihen më vetëm si formulime abstrakte që nuk kanë rëndësi praktike për individët as institucionet publike që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit. Parimet e Aarhusit në legjislacionin mjedisor janë pranuar në kohë të qëlluar nga autoritetet e Kosovës, në procesin e krijimit të ligjeve mjedisore dhe kanë shërbyer si një pikënisje për zhvillimin e zgjidhjeve ligjore që përfshijnë aspektet për qasje në informata, pjesëmarrje publike dhe qasje në drejtësi në fushën e mjedisit. Duke ditur karakterin jo të detyrueshëm ligjor të Aarhusit (ngaqë Konventa nuk është ratifikuar ende – edhe pse Kapitulli III i Kornizës Kushtetuese mundëson një vrojtim të tillë) ligjbërësit në Kosovë me kohë kanë kuptuar rëndësinë e pranimit të kërkesave të Aarhusit në legjislacion mjediosor në të gjitha përpjektjet e tyre për të zhvilluar legjislacion të mirëfillt dhe përshtatshëm në pajtueshmëri me legjislacionin e Bashkësisë Evropiane. Kjo flet qartë për rritjen e kuptimit të parimeve kyçe të legjislacionit mjedisor dhe nevojën urgjente për të përafruar legjislacionin vendor me atë të Bashkësisë Evropiane.

Megjithatë, një observim më i afërt i përfshirjes së Konventës Aarhus në legjislacionin kosovar, indikon një numër pengesash dhe mangësish në legjislacion të cilat nuk duhet të kalojnë pa u vërejtur në një studim që ka të bëjë më përafrimin e legjislacionit mjedisor të Kosovës me parimet e Konventës Aarhus në legjislacionin vendor. Me siguri që ka edhe shumë shembuj që tregojnë se kërkesat e Konventës së Aarhusit.. Shembuj të mangësive të tilla legjislative veç janë dhënë por e vlen të përsëriten edhe njëherë pa hyrë në shumë detaje.

Si u tha më lartë, parimi i pjesëmarrjes publike duhet të gjejë shprehje në Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit, në pajtim me Nenin 6 të Konventës Aarhus. Ligji duhet të theksojë qartë të drejtën e publikut për t'u informuar rreth procedurave të vendimmarrjes mjedisore në kohë sa më të hershme, në mënyrë efikase dhe adekuate. Informacioni duhet të përfshijë aktivitetin e propozuar, natyrën e vendimeve apo draft vendimeve të mundshme, autoritetin publik përgjegjës për vendimmarrje dhe procedurën e planifikuar. Këto janë kërkesa që dalin nga Konveta Aarhus dhe duhet të përfshihen në Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit.

Mungesa e aranzhimeve të përshtatshme sa i përket pjesëmarrjes publike në Ligjin për Mbrojtjen e Ajrit është evidente. Ashtu siç qëndron Ligji tani, ai nuk ofron instrumente ligjore të mjaftueshme për të lejuar qasjen në të dhëna rreth ndotjes. Poashtu ky ligj dështon në sigurimin e një vendi të përshtatshëm në strukturën e përgjithshme për pjesëmarrjen publike. Një dispozitë për sigurimin e konsultimeve të obligueshme publike gjatë procesit të lejeve mjedisore për aktivitetet të cilat shkaktojnë ndotje do të mjaftonte në kontekst të kërkesave të Aarhusit.

Vlerësime të njëjta vlejën edhe për Ligjin e Kuvendit për Mbeturina. Edhe përkundër referimit të drejtpërdrejtë në Konventën e Aarhusit, autoritetet ligjbërëse kanë dështuar në sigurimin e vendit të merituar për pjesëmarrje publike në kornizën e përgjithëshme të ligjit. Kjo kryesisht rezultoi nga qasja e kufizuar e përdorur në ligj edhe sa i përket pjesëmarrjes në hartimin e dokumenteve dhe programeve lidhur me menaxhimin e mbeturinave. Si është rekomanduar edhe më herët, Ligji duhet të ofrojë një qasje më gjithëpërfshirëse dhe më të gjerë, e cila do të mundësonte pjesëmarrje publike më të gjerë në dizajnimin dhe aprovimin e programeve dhe dokumenteve të lidhura me menaxhimin e mbeturinave. Ky obligim buron nga kërkesat e Konvnetës Aarhus, Neni 6 dhe si i tillë meriton të përfshihet në Ligjin e Kuvendit para se ai të hyjë në fuqi.

Sa i përket Ligjit të PK për Mbrojtjen e Natyrës, kërkesat e Konventës së Aarhusit duhet të përfshihen në mënyrë më të fuqishme. Edhe përkundër qëllimit të deklaruar të Ligjit sa i përket qasjen në informata, një përfshirje më e qartë e parimeve për qasje në informata, për pjesëmarrje publike dhe për qasje në drejtësi do të sillte parimet e Aarhusit edhe më afër aplikimit dhe aprovimit nga autoritetet lokale. Njësoj sikur edhe përfshirja e parimeve tjera në të cilat bazohet ligji dhe autoritetet përkatëse, edhe

përfshirja e parimeve të Aarhusit në këtë Ligj do të përcaktonte kornizat mbi të cilat individët dhe autoritetet publike do të operonin në çështjet e lidhura me mjedisin. Edhe pse përfshirja e Konventës së Aarhusit në përgjithësi nuk është obligativ për palët kontraktuese, ndërmarrja e masave të nevojshme legjislative, rregullative dhe masave tjera nga shtetet kontraktuese do të sillte deri te një përputhshmëri në mes dispozitave vendore për ofrimin e informatave, pjesëmarrjes publike, dhe qasjes në drejtësi, parime këto të shprehura qartë në Konventën e Aarhusit dhe të cilat duhet të gjejnë shprehje në legjislacionin vendor.

Sidoqoftë, vlen të theksohet se hartimi i ligjeve mjedisore në Kosovë është në proces të përfshirjes dhe modifikimeve të nevojshme për të përmbushur kërkesat për mbrojtjen e mjedisit, që janë gjithnjë në rritje. Për të arritur këtë synim, duhet të reflektohen dhe përfshihen qartë në këtë legjislacion parimet dhe rregullat e përgjithëshme të pranuar për mbrojtjen e mjedisit. Sa i përket instrumenteve ndërkombëtare ligjore në legjislacionin mjedisor, Konventa e Aarhusit për Qasje në Informata, Pjesëmarrje Publike dhe Qasje në Drejtësi mbetet njëri ndër instrumentet më të rëndësishme mbi të cilin legjislacionin vendor duhet ndërtuar. Deri më tani, Konventa e Aarhusit është pranuar nga shumë autoritete nacionale (pas procesit të ratifikimit) dhe ka përcaktuar themelet në bazë të të cilave autoritetet nacionale duhet të zhvillojnë legjislacion primar dhe dytësor në fushën e mjedisit. Në përgjithësi, Kosova nuk bën përjashtim në këtë praktikë edhe përkundër faktit që nuk është anëtare e Konventës. Pranimi i Konventës në legjislacionin mjedisor vendor dhe kuptimi i autoriteteve ligjbërëse ndaj Aarhusit dhe legjislacionit ndërkombëtar në përgjithësi është një indikator i qartë që tregon kuptimin e nevojës për të bartur parimet e ligjeve ndërkombëtare në legjislacionin vendor dhe për të vendosur përgjegjësi mbi agjencitë dhe institucionet përkatëse për të zbatuar parimet e Konventës së Aarhusit. Në pajtim me përafrimin e legjislacionit mjedisor, autoritetet publike në Kosovë do të vazdhojnë të ballafaqohen me sfida të mëdha sa i përket legjislacionin mjedisor – implementimin dhe zbatimin e këtij legjislacioni. Përderisa masa deri në të cilën ky legjislacion është analizuar, kushtëzohet nga shumë faktor si dhe nga vet mjedisi ku ky legjislacion zbatohet, është e qartë se ky legjislacionin nuk do të zbatohet në masë të duhur deri sa nuk të vendosen mekanizma dhe instrumentet juridike dhe operative për të siguruar zbatim të kënaqshëm të këtij legjislacioni.